



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Master tema

Gamification si metodologji e re në mësimdhënie.. Përdorimi i Këtij Modeli Në Shkollat
E Mesme Në Republikën E Maqedonisë Veriore

Kandidati
Agona Lleshi

Tetovë
Mars, 2022

Mentor
Assoc. Prof. Dr. Visar Shehu

Abstrakti

Ky punim shkencor do të hulumton rreth aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në procesin mësimor, shfrytëzimin e teknikave dhe modeleve të reja elektronike për mjedis mësimor sa më të përshtatshëm dhe efektiv. Fushë me interes te madh hulumtimi, kohëve të fundit është procesi i ashtuquajtur *gamification* ku kërkohet që të implementohen sisteme që përmes lojës ti nxisin nxënësit të mësojnë më tepër. Si pjesë e kërkimit të teknikave të reja, në këtë hulumtim kemi shqyrtuar mundësinë e aplikimit të *Gamification* në arsim.

Gamification është integrim i elementeve të lojës në aktivitete që nuk janë lojëra. Futja e elementeve të lojës në kontekste jo loje, ka potencial për të përmirësuar të nxënit duke rritur motivimin e nxënësve. Megjithatë, ka pak prova për efektivitetin e tij. Prandaj do të hulumtohet si ndikojnë teknikat e modelit *gamification* në motivimin dhe arritjet e nxënësve.

Në këtë studim, mësuesi i matematikës realizoi mësimin në klasë me ndihmën e teknikave të modelit *gamification*. Rezultatet e provimit të një numri të caktuar të nxënësve u krahasuan me rezultatet e provimeve të numrit të njejtë të nxënësve ku mësimi është zhvilluar në formë tradicionale. Një test statistikor u përdor për të krahasuar secilën kategori nëpërmjet grupit të trajnuar (lojëtarët) dhe grupit tradicional.

Disa pyetësorë në lidhje me zbatimin e TIK në procesin mësimor dhe shfrytëzimin e modelit *gamification* me aplikacionet që e ofrojnë atë, janë plotësuar nga nxënës dhe mësime të shkollave të mesme dhe janë analizuar përgjigjet e tyre.

Hulumtimi dhe projekti zhvillohet nëpërmjet eksperimentit me nxënës të shkollave të mesme me shfrytëzim të sistemeve elektronike për menaxhim me përmbajtjet mësimore (LMS) ose të ashtuquajturat platforma arsimore. Ata paraqesin mjedis të përshtatshëm për *gamification*, sepse kanë mjete për ndjekjen automatike të rezultateve dhe progresit të nxënësve.

Të gjitha të dhënat, duke filluar nga evidenca, lojërat, detyrat e shtëpisë të arriturat graduale të nxënësve janë zhvilluar në klasë si mjedis tradicional për zhvillimin e procesit mësimor dhe nëpërmjet platformës arsimore, Microsoft Teams, duke inkuadruar

gjithashtu disa aplikacionet të përshtatshme për zbatim të modelit gamification si *Kahoot!* dhe *Quizizz*.

Puna aktuale e tezës gjen disa mangësi në fushën e kërkimit duke marrë parasysh përdorimin e modelit gamification në arsim. E ardhmja e këtij modeli në arsim varet nga rregullimi i këtyre mangësive.

Përmbajtja

Abstrakti	2
Lista e figurave	6
Lista e tabelave	8
HYRJE	9
1.1. Diskutimi i problemit	9
1.2. Motivimi	11
1.3. Qëllimet e hulumtimit	12
1.4. Hipotezat	14
2. Studimi i literaturës	15
2.1. Zbatimi i TIK në procesin mësimor	16
2.1.1. Mjetet e vlerësimit online	16
2.2. Modeli Gamification	35
2.2.1. Evolucioni i modelit gamification	38
2.2.2. Dizajnimi i modelit Gamification	43
3. Gamification në matematikë	48
3.1. Gamification si model motivimi në lëndën e matematikës	49
3.2. Disa studime që ndërlidhen me ndikimin modelit gamification në lëndën e matematikës	51
3.3. Zbatimi i modelit gamification në lëndën e matematikës me aplikacionin Kahoot!	53
3.3. Zbatimi i modelit gamification në lëndën e matematikës me aplikacionin Quizizz!	55
4. Eksperimenti	57
4.1. Metodologjia e hulumtimit	57
4.2. Shfrytëzimi i platformës arsimore	58
4.2.1. Mësimi në distancë me zbatim të platformës arsimore	59
4.3. Mbledhja e të dhënave për hulumtim	60
4.3.1. Pyetësorët: I, II, III.	61
4.3.2. Implementimi i modelit gamification në lëndën e matematikës (intervistë)	63
4.3.3. Testim në lëndën e matematikës në formë tradicionale dhe elektronike	66
4.4. Analiza e të dhënave	80
4.4.1. Analiza e pyetësorit I	80
4.4.2. Analiza e pyetësorit II	82

4.4.3. Analiza e pyetësorit III	85
4.4.4. Analiza e intervistës me mësimdhënësnt e matematikës	87
4.4.5. Analiza e rezultateve të nxënësve në test	88
4.5. Rezultatet përfundimtare	94
4.5.1. Diskutimi	99
Bibliografia	100

Lista e figurave

FIGURE 1. IMPLEMENTIMI I TIK NË PROCESIN MËSIMOR.	11
FIGURE 2. KAHOOT!	18
FIGURE 3. REGJISTRIMI NË KAHOOT!	18
FIGURE 4. ZGJIDH LLOJIN E LLOGARISË NË KAHOOT!	19
FIGURE 5. PËRSHKRUAJ VENDIN E PUNËS NË KAHOOT!	19
FIGURE 6. KAHOOT! BASIC, PRO, PREMIUM, PREMIUM+	20
FIGURE 7. KRIJIMI I NJË KUIZI NË KAHOOT!	21
FIGURE 8. SHPËRNDARJA E KUIZIT TEK NXËNËSIT	22
FIGURE 9. FORMA E KUIZIT: INDIVIDUALE APO NË GRUP	23
FIGURE 10. REZULTATET E KUIZIT NË KAHOOT!	24
FIGURE 11. APLIKACIONI QUIZIZZ	25
FIGURE 12. REGJISTRIMI NË QUIZIZZ	26
FIGURE 13. KRIJIMI I NJË KUIZI NË QUIZIZZ	26
FIGURE 14. ZGJEDHJA E LLOJIT TË PYETJES GJATË KRIJIMIT TE NJË KUIZI NË QUIZIZZ	27
FIGURE 15. VENDOSJA E FOTOGRAFIVE, VIDEO-MATERIALEVE, KOHËMATËSIT GJATË KRIJIMIT TË KUIZIT NË QUIZIZZ	28
FIGURE 16. SHTIMI DHE NDRYSHIMI I PYETJEVE TË KUIZIT NË QUIZIZZ.	29
FIGURE 17. RUAJTJA E KUIZIT TË KRIJUAR NË QUIZIZZ	29
FIGURE 18. FORMA E REALIZIMIT TË KUIZIT ME NXËNËSIT: NË KOHË REALE OSE SI DETYRË SHTËPIE	30
FIGURE 19. SHTIMI I NJË KLASË NGA "GOOGLE CLASSROOM"	31
FIGURE 20. KUIZI I DHËNË SI DETYRË SHTËPIE NË QUIZIZZ	31
FIGURE 21. SHPËRNDARJA E KUIZIT TEK NXËNËSIT NËPËRMJET PLATFORMËS	32
FIGURE 22. PJESËMARRJA NË KUIZ ME ANË TË KODIT	32
FIGURE 23. RAPORTI I KUIZIT NË QUIZIZZ	33
FIGURE 24. REZULTATET E DETAJUARA TË KUIZIT NË QUIZIZZ!	33
FIGURE 25. MODELI GAMIFICATION	38
FIGURE 26. HIERARKIA E ELEMENTEVE TË LOJËS (WERBACH, 2014)	42
FIGURE 27. KORNIZA MDE E DIZAJNIMIT TË LOJËS (GEDE PUTRA KUSUMA, 2018)	47
FIGURE 28. PARAQITJA E PYETJEVE TË KUIZIT NË KAHOOT!	54
FIGURE 29. PARAQITJA E PYETJEVE TË KUIZIT MATEMATIKOR NË QUIZIZZ.	56
FIGURE 30. SAKTËSIA/PASAKTËSIA E PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE NË KAHOOT! E SHPREHUR NË PËRQINDJE.	66
FIGURE 31. PËRGJIGJET E DETAJUARA TË NXËNËSVE NË PYETJEN E TESTIT NË KAHOOT!	67
FIGURE 32. PYETJET DHE SAKTËSIA E PËRGJIGJEVE TË SECILËS PYETJE TË DHËNË NË TESTIN E VITEVE TË III-TA NË KAHOOT!	70
FIGURE 33. PYETJET DHE DETYRAT E TESTIT ME ILUSTIME NË QUIZIZZ	72
FIGURE 34. REZULTATET E NXËNËSVE TË VITIT TË III NË TEST NË QUIZIZZ.	73
FIGURE 35. SAKTËSIA/PASAKTËSIA E NXËNËSVE TË VITIT TË PARË NË TESTIN NË QUIZIZZ.	77
FIGURE 36. REZULTATET E DETAJUARA TË TESTIT TË NJË NXËNËSI NË QUIZIZZ.	78
FIGURE 37. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	80
FIGURE 38. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	80
FIGURE 39. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	81
FIGURE 40. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	81
FIGURE 41. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	81
FIGURE 42. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	82
FIGURE 43. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT I.	82
FIGURE 44. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT II.	83
FIGURE 45. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT II.	83
FIGURE 46. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETËSORI II	84
FIGURE 47. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT III	86
FIGURE 48. PËRFAQËSIMI NË PËRQINDJE I SECILËS NGA PËRGJIGJET TEK PYETJA E PYETËSORIT III	87

FIGURE 49. NDËRLIDHJA: MËSIMDHËNËS - MODELI GAMIFICATION - NXËNËS	88
FIGURE 50. DIAGRAM SEKTORIAL I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË REZULTATEVE TË TESTIT NË FORMË TRADICIONALE.	89
FIGURE 51. DIAGRAM SEKTORIAL I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË REZULTATEVE TË TESTIT NË KAHOOT!	89
FIGURE 52. DIAGRAM SEKTORIAL I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË REZULTATEVE TË TESTIT NË QUIZIZZ.	90
FIGURE 53. DIAGRAM I KRAHASIMIT TË REZULTATEVE NË TRE FORMAT E TESTIMIT.	91
FIGURE 54. DIAGRAM SEKTORIAL I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË REZULTATEVE TË GRUPIT TË I PËR NXËNËSIT E VITIT TË I.	92
FIGURE 55. DIAGRAM SEKTORIAL I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË REZULTATEVE TË GRUPIT TË II PËR NXËNËSIT E VITIT TË I.	92
FIGURE 56. DIAGRAM I KRAHASIMIT TË REZULTATEVE TË NXËNËSVE TË VITIT TË I NË TESTIMIN ME SHKRIM DHE NË QUIZIZZ!	93
FIGURE 57. DIAGRAM I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË PËRGJIGJEVE TË MËSIMDHËNËSVE MBI ZBATIMIN E TIK NË LËNDËT MËSIMORE.	94
FIGURE 58. DIAGRAM I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË PËRGJIGJEVE TË MËSIMDHËNËSVE NË LIDHJE ME NDIKIMIN E TIK NË AKTIVITETIN E NXËNËSVE.	94
FIGURE 59. DIAGRAM I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE NË LIDHJE ME ZBATIMIN E TIK NË LËNDËT MËSIMORE.	95
FIGURE 60. DIAGRAM I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE MBI NJOHJEN E TERMIT "GAMIFICATION"	95
FIGURE 61. PËRFAQËSIM NË PËRQINDJE I MENDIMIT TË MËSIMDHËNËSVE PËR ORËN MËSIMORE MË TË SUKSESSHME.	96
FIGURE 62. DIAGRAM I PËRFAQËSIMIT NË PËRQINDJE TË PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE NË LIDHJE ME REZULTATET E ARRITURA NË TESTE	97
FIGURE 63. DIAGRAM I REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË TESTIMIT ME SHKRIM, NË KAHOOT! DHE NË QUIZIZZ.	97
FIGURE 64. REZULTATET E TESTIMIT II ME NXËNËSIT E VITEVE TË I, TË REALIZUAR ME SHKRIM DHE NË QUIZIZZ.	98

Lista e tabelave

TABLE 1. PIKËT E FITUARA NGA NXËNËSIT NË TESTIN NË FORMË KUIZI NË KAHOOT!	68
TABLE 2. REZULTATET E DETAJUARA TË NXËNËSVE TË VITIT TË III NË TEST NË QUIZZ.	74
TABLE 3. REZULTATET E NXËNËSVE NË TESTIMIN ME SHKRIM - NË FORMË TRADICIONALE	74
TABLE 4. REZULTATET E GRUPIT TË DYTË TË NXËNËSVE TË VITIT I NË TESTIN E REALIZUAR NË QUIZZ.	76
TABLE 5. REZULTATET E TESTIMIT ME SHKRIM TË GRUPIT TË II TË NXËNËSVE TË VITIT I	79
TABLE 6. REZULTATET E TESTIMIT ME SHKRIM TË GRUPIT TË II TË NXËNËSVE TË VITIT I	90
TABLE 7. KRAHASIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA NXËNËSIT E VITIT TË III GJATË TESTIMIT.	91
TABLE 8. KRAHASIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA GJATË TESTIMIT ME NXËNËSIT E VITIT TË I	92
TABLE 9. KRAHASIMI I REZULTATEVE NË BAZË TË NOTËS MESAWARE TË TESTIT PËR NXËNËSIT E VITIT TË III	98
TABLE 10. KRAHASIMI I REZULTATEVE NË BAZË TË NOTËS MESAWARE TË TESTIT PËR NXËNËSIT E VITIT TË I	98

HYRJE

1.1. Diskutimi i problemit

Në ditët e sotme teknologjia është kudo, e lidhur pothuajse me çdo pjesë të kulturës tonë. Ndikon në mënyrën si jetojmë, punojmë, luajmë dhe më së shumti si mësojmë. Një nga arsyet që justifikon nevojën e ndryshimeve në sistemin arsimor është pikërisht aplikimi i teknologjisë në çdo fushë të zhvillimit shoqëror.

Me zhvillimin e teknologjisë duket sikur metodat tradicionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies nuk mjaftojnë dhe ndjehet nevoja e zbatimit të metodave të reja bashkëkohore.

Teksa teknologjia po merr gjithnjë e më shumë hapësirë në jetën tonë të përditshme, zbatimi i teknologjisë për të mësuar në një kontekst shkollor ndoshta do të bëhet gjithnjë e më i zakonshëm.

Mënyra tradicionale e zhvillimit të procesit mësimor përparoi drejt qasjeve të reja në mësimdhënie dhe nxënie me aplikimin e mjeteve të mësimit elektronik.

Problemet kryesore në arsimin modern janë të lidhura me mungesën e angazhimit dhe motivimit të nxënësve për të marrë pjesë aktive në procesin e të mësuarit. Për shkak të kësaj, mësuesit përpiqen të përdorin teknika dhe qasje të reja për të provokuar aktivitetin e nxënësve dhe për t'i motivuar ata të marrin pjesë në trajnime.

Duket se ngjarja më me ndikim në zhvillimin arsimor të shekullit të XXI është pikërisht teknologjia. Nuk ka të bëjë vetëm me teknika të reja për mësimdhënie dhe vlerësim, teknologjia ka një ndikim të madh në karakteristikat e nxënësve të shekullit të 21-të, nevojat, interesat dhe mënyrat e të nxënësve. Dituria dhe informacioni tani janë brenda një butoni për të gjithë në çdo kohë, mësuesit nuk janë më burimi i këtij informacioni. Objektivat e rinj të të mësuarit tani janë ndërtimi i aftësive dhe jo vetëm kalimi i informacionit. Mësuesi tani është një lehtësues për procesin e të mësuarit që është

ndërtuar mbi kuriozitetin e nxënësve për të kërkuar dijen, dhe fokusi është në "kërkimin" më shumë se sa në "dijen". Për dallim nga mësimi tradicional, i cili varet nga mësimet e drejtuara nga mësime të mësimdhënësve me nxënës pasivë, shumë programe bashkëkohore të reformës arsimore përdorin qasje të përqëndruara tek nxënësit.

Presioni i teknologjisë në rritje dhe zgjerim kaq të shpejtë ndikon edhe në zhvillimin profesional të mësime të mësimdhënësve, të cilët duhet të jenë të përgaditur për "stilin kompjuterik" të mësimdhënies, prandaj është i domosdoshëm zhvillimi i vazhdueshëm profesional i tyre bazuar në hapat e zhvillimit teknologjik. E Përdorur për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien, teknologjia fut klasat me mjete digjitale të të nxënësve, të tilla si kompjuterë dhe pajisje të ngjajshme, zgjeron ofertat e lëndëve, përvojat dhe materialet mësimore, mbështet të mësuarit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, ndërton aftësitë e shekullit XXI, rrit angazhimin dhe motivimin e nxënësve, dhe përshpejton të mësuarit. Ky model i lidh mësuesit me nxënësit e tyre dhe me përmbajtjet profesionale, burimet dhe sistemet për t'i ndihmuar ata të përmirësojnë mësimet e tyre dhe të personalizojnë mësimin. Mundësitë për të mësuar në distancë (online) dhe përdorimi i burimeve të hapura arsimore dhe teknologjive të tjera mund të rrisin produktivitetin arsimor duke përshpejtuar shkallën e të mësuarit, reduktimin e kostove të lidhura me materialet mësimore ose shpërndarjen e programeve, dhe duke shfrytëzuar më mirë kohën e mësuesit.

Teknologjia është aplikimi praktik i shkencës. Përveç zhvillimit në teknologjitë e informacionit, janë duke u prezantuar metoda të reja të mësimdhënies dhe mësimin për të avancuar arsimin bashkëkohor. Teknologjia mbështet të menduarit global në një shoqëri të arsimuar dhe ofron informacion për të adoptuar zhvillime të reja të mësimdhënies dhe mësimin. Është e rëndësishme të përcaktohet teknologjia e përshtatshme për të rritur produktivitetin bazuar në nevojat e nxënësve dhe mësuesve.

Mësuesit po përballen me sfida të reja dhe duhet të zgjidhin çështje të rëndësishme që lidhen me përshtatjen e procesit mësimor drejt nevojave, preferencave dhe kërkesave të nxënësve. Mësuesit duhet të përdorin metoda të ndryshme mësimdhënieje dhe qasje që

i lejonë nxënësit të jenë pjesëmarrës aktivë me motivim dhe angazhim të fortë ndaj të mësuarit. Tendencat moderne pedagogjike në arsim, të përforcuara nga përdorimi i TIK-ut, krijojnë parakushtet për përdorimin e qasjeve dhe teknikave të reja për zbatimin e të nxënit aktiv. Modeli gamification në zhvillim është një nga këto tendenca. Ndonëse kjo metodë është aplikuar me sukses në fusha të tjera si marketingu dhe rrjetet sociale, zbatimi në arsim është ende në fazën fillestare. Gamification është përdorimi i elementeve të lojës në aktivitete që nuk janë lojëra. Elementet e lojës, pikët, distinktivët dhe tabelat e drejtuesve, mund të përdoren nga mësuesit në procesin e tyre të mësimit dhe të të nxënit. Kjo mund të bëhet ose nëpërmjet klasës tradicionale ose klasës online. Qëllimi i punës në vijim është të studiojë dhe prezantojë natyrën dhe përfitimet e *gamification* dhe për të dhënë disa ide se si të zbatohet në arsim.



Figure 1. Implementimi i TIK në procesin mësimor.

1.2. Motivimi

Teknologjia nuk paraqet vetëm instrumente elektronike, ajo përfshin metoda të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies që mund të përdoren në mënyrë të dobishme në arsim.

Fushë me interes të madh hulumtimi kohëve të fundit është procesi i ashtuquajtur *gamification* ku kërkohej që të implementohen sisteme që përmes lojës të nxënësit të mësojnë më tepër. *Gamification* është procesi i aplikimit të mekanikës të lojërave në kontekste jo-lojë dhe ka fituar popullaritet në disa industri të ndryshme. Gamification është përdorimi i parimeve të lojërave në fushën e arsimit, në mënyrë që nxënësit të përfshihen, të angazhohen dhe të motivohen për të mësuar. Gamification prezanton koncepte si shenjat, nivelet, arritjet dhe pikat e lojës në klasë. Nxënësit shpërblehen me këto koncepte kur ato arrijnë, por nuk penalizohen kur nuk e bëjnë këtë. Duke futur një sistem shpërblimesh pa dënime të ashpra, studentët nuk kanë frikë të dalin jashtë zonës së tyre të rehatisë dhe të dështojnë. Duke hequr frikën nga dështimi, ne inkurajojmë ata në mënyrë të pavetëdijshme për të mësuar. Mbi të gjitha ideja është që mësuesit të jenë lehtësues, motivatorë dhe jo udhëheqës në klasë.

Dizajnerët e lojërave arsimore përballen me shumë sfida, njëra prej të cilave e bën të kënaqshme përvojën e të nxënësit. Dizajnerët e lojërave edukativo-arsimore duhet të fokusohen në objektivat e të mësuarit dhe në lojëra për të motivuar nxënësit.

Objektivat e të mësuarit duhet të jenë specifike dhe të përcaktuara qartë. Qëllimi i arsimit është arritja e objektivave të të mësuarit, sepse përndryshe të gjitha aktivitetet (përfshirë aktivitetet e lojës) do të duken të pakuptimta. Objektivat përcaktojnë se çfarë përmbajtje arsimore dhe aktivitete duhet të përfshihen në procesin e të mësuarit dhe zgjedhjen e mekanikës të përshtatshme të lojës dhe teknika për t'i arritur ato.

Lojërat kanë fuqi të jashtëzakonshme motivuese, ata përdorin një numër mekanizmesh për të inkurajuar njerëzit që të angazhohen me ta, shpesh pa ndonjë shpërblim, vetëm për gëzimin e lojës dhe mundësinë për të fituar. Megjithatë, krijimi i një loje mësimore mjaft të angazhuar dhe të plotë, është e vështirë, harxhuese dhe e kushtueshme, ndërsa në mënyrë tipike synon vetëm një sërë objektivash mësimore të zgjedhura nga

projektuesi i lojës. Përveç kësaj, miratimi i tyre efektiv në klasë kërkon një infrastrukturë të caktuar teknike dhe një integrim të duhur pedagogjik. Në kundërshtim me përdorimin e lojërave të përpunuara që kërkojnë një sasi të madhe të përpjekjeve për dizajn dhe zhvillim, qasja "*gamification*" sugjeron përdorimin e të menduarit të lojës dhe elementeve të dizajnit të lojërave për të përmirësuar angazhimin dhe motivimin e nxënësve.

Gamification përpiqet të ndjek fuqinë motivuese të lojërave dhe ta zbatojë atë në problemet e botës reale - siç janë, në rastin tonë, problemet e motivimit në shkolla. Motivimi dhe angazhimi janë sfida kryesore për sistemin arsimor në vendin tonë.

Hulumtimi në këtë punim do të bazohet në rezultatet që do sjell eksperimenti i zhvilluar me nxënës të shkollave të mesme publike në Republikën e Maqedonisë Veriore.

1.3. Qëllimet e hulumtimit

Problemet kryesore në arsimin modern janë të lidhura me mungesën e angazhimit dhe motivimit të studentëve për të marrë pjesë aktive në procesin e të mësuarit. Zhvillimet e shpejta teknologjike kanë ndikuar edhe në arsim, por qëllimi është që të gjenden modele mësimore që përmes shrytëzimit të teknologjisë nxënësit të mësojnë më tepër dhe të arrijnë rezultate më të mira.

Sistemet elektronike për menaxhim me përmbajtjet mësimore (LMS) kanë filluar të përdoren në shumë lëndë nëpër shkolla të mesme, që nga momenti kur aplikimi i TIK në planprogramet mësimore u bë ligjërish i detyrueshëm. Qëllimi i tyre është që nxënësit të pajisen me materialet mësimore dhe ti ndjekin ato në formë elektronike. Platforma të caktuara të rrjetit për arsim kanë hapësirë për mbajtjen e evidencës së aktivitetit të nxënësve, kuize, lojëra arsimore etj.

Megjithatë, sistemet elektronike për menaxhim me përmbajtjet mësimore me një fokus të qartë tek *gamification* aktualisht janë të rallë.

Lojërat, në çdo formë, rrisin motivimin përmes angazhimit. Askund tjetër nuk është kjo më e rëndësishme sesa në arsim.

Përveç promovimit të përfitimeve specifike të të mësuarit, lojërat janë një formë e mësimit aktiv. Zbatimi i elementeve të lojës në arsim është logjik pasi ekzistojnë disa fakte që janë tipike për lojërat dhe trajnimet. Veprimet e përdoruesve në lojëra kanë për qëllim arritjen e një qëllimi specifik (fitore) në prani të pengesave.

Në arsim ekziston një objektiv mësimi, i cili duhet të arrihet duke kryer aktivitete specifike mësimore ose ndërveprim me përmbajtjen arsimore.

Qëllimi i mekanikës së lojërave është për të rritur motivimin apo të shpërblejë njerëzit për të kryer një detyrë të veçantë (Haselwood). Përdorimi i modelit *Gamification* në mjedisin edukativo-arsimor mund të ketë rezultate pozitive (Penny de Byl, 2013) dhe mund të rrisë angazhimin e nxënësve (Gabner-Hagen, 2015).

Qëllimi i këtij studimi është të hetojë se cilat mekanika të *gamification* do të ndihmojnë nxënësit të mbajë informacion të shpejtë dhe të japin nxënësve mundësinë për të mbajtur këtë informacion më të cilat duhet të rrisin rezultatet e testit.

Pikësnyim i rëndësishëm në këtë hulumtim është ngritja e vetëdijes për përdorimin e elementeve të lojës në aplikacionet e të mësuarit dhe në rezultatet që ato ofrojnë. Një tjetër qëllim kryesor është shqyrtimi i përvojës së përdoruesit dhe nëse *gamification* mund të ndihmojë për të krijuar një përvojë të mirë përdorimi.

Qëllimet e këtij hulumtimi do të bazohen në të mësuarit e lëndëve nëpërmjet modelit *gamification*, do të mundohemi që nëpërmjet përdorimit të mekanikave të lojërave dhe aplikacioneve me zbatim të këtij modeli nxënësit të angazhohen, të mësojnë dhe ta shijojnë të mësuarit e lëndëve mësimore.

Kjo tezë do të hulumtojë efektet e modelit *gamification* në motivimin dhe performancën e nxënësve të shkollave të mesme.

1.4. Hipotezat

Hulumtimi në këtë punim shkencor do të vërtetohet mbi bazat e këtyre hipotezave:

Implementimi i TIK në procesin mësimor është i realizueshëm dhe do të shtojë interesimin e nxënësve.

Gamification si teknikë është e zbatueshme në lëndët mësimore dhe do ti bëjë ato më tërheqëse.

Për mësimdhënësit është më e përshtatshme ta zhvillojnë procesin mësimor me zbatim të TIK dhe modelit *gamification* duke evituar mënyrën tradicionale të mësimdhënies.

Nxënësit të cilët do ti nënshtrohen mësimi dhe testimit me anë të teknikës *gamification* do të tregojnë rezultate më të mira.

2. Studimi i literaturës

Hulumtimet për aplikimet e lojrave dhe të nxënësve janë të lidhura me disa fusha të tjera kërkimore.

Fushat kryesore që përbëjnë thelbin e modelit *gamification* janë teknologjia, lojërat dhe mësimi.

Në ndërveprimin e këtyre tre zonave janë lojëra dixhitale, lojëra serioze dhe nxënie të avancuar në teknologji, kryqëzimi qendror që këto elemente formojnë së bashku është *gamification*.

Lojërat digjitale janë bërë pjesë e kulturës moderne ku pothuajse të gjithë fëmijët luajnë lojëra dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë në moshën e rritur (Oblinger, 2006), një deklaratë e konfirmuar nga shoqata e softuerit për argëtim (ESA), e cila ka krijuar një pasqyrë për faktet rreth industrisë së kompjuterave dhe videove në SHBA, ka deklaruar se lojtari mesatar është 30 vjeç (Entertainment Software Association 2008). Lojërat digjitale kanë një treg dhe audiencë të madhe, e cila përbën bazën e suksesit për *gamification* (ESA, 2008).

Përdorimi i elementeve të lojës në aplikacione për të mësuar duket interesante si për lojëtrët ashtu edhe në arsim.

Lojëra serioze është e lidhur ngushtë me modelin *gamification* si qëllimi kryesor i lojrave serioze është të ndiçon një çështje serioze përmes një lojë. (Tarja Susi, 2007) përcaktojnë lojëra serioze si "Lojra të përdorura për qëllime të tjera përveç argëtimit të thjeshtë".

Duke e reduktuar në thelbin e saj formal, një lojë është një aktivitet midis dy ose më shumë vendimmarrësve të pavarur që kërkojnë të arrijnë objektivat e tyre në një kontekst kufizues.

Përkufizimi konvencional do të thoshte se një lojë është një kontekst me rregullat midis kundërshtarëve që përpiqen të fitojnë objektiva.

Dallimi midis lojrave serioze dhe llojeve të tjera të lojrave të njohura si *edutainment* mund të jetë që e para ka disa qëllime serioze të ndërhuara, ndërsa kjo e fundit bëhet serioze kur përdoruesi vendos të caktojë një qëllim të tillë. Lojërat serioze janë zhvilluar me qëllime serioze të të menduarit, ndërsa *edutainment* janë lojëra të destinuara për qëllime arsimore, por me elementin e argëtimit.

2.1. Zbatimi i TIK në procesin mësimor

2.1.1. Mjetet e vlerësimit online

Mësimdhënia në një klasë virtuale është një sfidë dhe mundësi për të bërë një hap përpara për vlerësim në mënyrë që të vlerësohen proceset kognitive komplekse (analiza,

sinteza, vlerësimi), në vend që të përvetësohen njohuritë faktike që, në fakt, janë qëllimi i edukimit.

Vlerësimet mund të jenë formative, e projektuar për të monitoruar përparimin e nxënësve në një mjedis pa veprime, ose summative (përmbledhëse), e krijuar për të vlerësuar nxënësit sipas kriterëve. Shembuj të tillë ku janë përdorur zakonisht mjetet e vlerësimit digjital janë kuize të bazuara në *Google Form*, *Kahoot!*, *Quizizz*, *Socrative*, *Near Pod*, *Educanon*, etj. Së bashku me futjen e teknologjive inteligjente në klasë, përfshirja e skenarëve të mbështetur nga lojërat dhe konkurrenca mund të rrisin pjesëmarrjen e nxënësve. Për të bërë mësimin më interaktiv kuize, sondazhe dhe lojëra mund të përfshihen në mjedisin mësimor në distancë ose në klasë. Dy platforma të tilla janë *Kahoot* dhe *Quizizz*. Këto mjete mund të integrohen lehtësisht në platformat e mësimdhënies/të nxënësve në distancë por edhe në klasë. (Tanishta Barthan, 2020)

Kahoot! është një platformë mësimore me akses të hapur, e lehtë, e bazuar në lojë, e cila ofron lehtësinë për të kryer kuize të modelit *gamification* gjatë procesit mësimor. Mund të përdoret si një teknologji arsimore në shkolla dhe institucione të arsimit të lartë për të vlerësuar performancën e nxënësve dhe studentëve. Mësuesit mund të përdorin *Kahoot!* në dy mënyra: ose gjatë orës mësimore për të kontrolluar njohuritë e një studenti ose mund të caktohet për nxënësit në një datë të mëvonshme duke vendosur limit kohe. Pjesa më tërheqëse e kësaj platforme janë pyetjet e lidhura me kohën, ku mund të caktohet një kohëzgjatje duke filluar nga 5 sekonda deri në 240 sekonda për pyetje në një kuiz.

Kahoot është një aplikacion falas për t'u përdorur që mundëson krijimin e kuizeve mësimore argëtuese. Është krijuar për qëllime arsimore dhe kryesisht ka për qëllim nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit. *Kahoot!* u krijua gjatë një projekti të përbashkët që filloi në Universitetin Norvegjez të Teknologjisë dhe Shkencës dhe u shndërrua në një kompani në 2013 me mësimin dhe argëtimin në zemër.

Përdorimi i *Kahoot!* fillon me krijimin e një llogarie dhe në vazhdim kuizit përkatës. Është vërtet i shpejtë dhe i lehtë për të krijuar kuize. Mund të shtohen fotografi ose

video për t'iu bashkuar pyetjeve të kuizit. Gjithashtu mund të zgjidhet se sa kohë do të kenë lojtarët për t'iu përgjigjur pyetjeve. Sa herë që një lojtar merr një përgjigje të drejtë, *Kahoot!* e shpërblen atë me pikë që bazohen gjithashtu në shpejtësinë e përgjigjes. Pasi të gjithë janë përgjigjur, rezultatet shfaqen në ekran dhe mund të shihen sa përgjigje të sakta dhe të gabuara kanë dhënë lojtarët dhe një tabelë të vogël drejtuese me lojtarët me më shumë pikë në të.

Kahoot! ka shumë elementë të modelit *gamification*. Para së gjithash, ka pikë dhe një tabelë drejtuese që janë diskutuar aq shumë në *gamification*. Këto janë mekanikë të thjeshtë të lojës, por nëse zbatohen siç duhet ato mund të sjellin rezultate të shkëlqyera. Nuk është një sistem LMS, nuk ka nevojë të ketë shumë mekanikë lojërash për të angazhuar nxënësit për një kohë të gjatë. Ju e përdorni atë në klasë, e bëni mësimin më argëtues dhe më pas e përdorni përsëri kur të keni nevojë. Nuk është një sistem me të cilin njerëzit duhet të ndërveprojnë çdo ditë, kështu që është mekanika e thjeshtë e lojës dhe dizajni që funksionojnë shumë mirë. Megjithatë, ka një veçori shumë të dobishme, e cila është gjurmimi i rezultateve të të gjitha kuizeve dhe mund t'i ruajë ato në një skedar dhe t'i studiojë më vonë. Në këtë mënyrë mund të mbahet evidenca se sa mirë po ecin nxënësit për një kohë të gjatë.

Tani do të shohim si funksionon kjo platform dhe do të bëjmë një përshkrim hap pas hapi të krijimit të kuizeve dhe aksesin e nxënësve deri te ato.

Hapi 1: Hapni Google Chrome dhe shkruani Kahoot në shiritin e kërkimit. Do t'ju jepet një listë e opsioneve. Që mësuesit të regjistrohen dhe të krijojnë një kuiz, duhet të klikohet mbi <https://kahoot.com> dhe për nxënësit për t'iu bashkuar me çdo aktivitet të drejtpërdrejtë në platformën Kahoot, klikoni në <https://kahoot.it>.

Kahoot! funksionon edhe në formë aplikacioni për telefona inteligjentë dhe është lehtësisht i aplikueshëm.



Figure 2. Kahoot!

Hapi 2: Pas hapjes së Kahoot.com, duhet të regjistroheni nëse regjistroheshi për herë të parë. Përndryshe, ju mund të identifikoheni me llogarinë tuaj ekzistuese. Pasi të regjistroheshi, zgjidhni llojin e llogarisë tuaj (mësues, student, personal ose profesional) dhe përshkruani vendin tuaj të punës (shkollë, arsim i lartë, administrator i shkollës, biznes).



Figure 3. Regjistrimi në Kahoot!




Figure 4. Zgjidh llojin e llogarisë në Kahoot!




Figure 5. Përshkruaj vendin e punës në Kahoot!

Hapi 3: Hapi tjetër është zgjedhja e planit tuaj ku ka një mundësi për të zgjedhur midis planeve bazë falas dhe versioneve të tjera me pagesë. Qëllimi ynë bazë i vlerësimit në internet mund të shërbehet me planin bazik falas. Pra, mund të klikoni në “Get Basic for Free” dhe vazhdoni. Në versionet me pagesë, ofrohen më shumë mundësi, mund të zgjidhni deri në 2000 pjesëmarrës dhe të merrni të gjitha formularët e pyetjeve dhe veçoritë e mësimit në distancë. Institucionet dhe organizatat mund të përdorin versionin premium. Pas kësaj, do të shfaqet një

faqe mirësearchjeje dhe është opsionale të vendosni emrin ose pseudonimin tuaj atje. Pasi të keni kryer veprimet paraprake, do të jeni në faqen kryesore Kahoot!.

Level up Kahoot!'ing in any learning environment

Kahoot! empowers teachers to engage and motivate students, increase participation in class and virtually, and assess learning.

Individual | Team, School & District




Basic Free	Kahoot! Pro	Kahoot! Premium	Kahoot! Premium+
Basic Free	Kahoot! Pro	Kahoot! Premium	Kahoot! Premium+
Get started with Kahoot! basics	Teach interactive lessons	Unlock more customization	Become the ultimate Kahoot!er
<ul style="list-style-type: none">✓ Create kahoots with quiz questions✓ Host and play kahoots✓ Assign student-paced kahoots✓ Up to 50 players per game	<ul style="list-style-type: none">✓ Polls, puzzles and multi-select answers✓ Advanced slide layouts✓ Premium image library✓ Up to 100 players per game	<ul style="list-style-type: none">✓ Type answer question✓ Audio-in questions✓ Personalized learning✓ Up to 200 players per game	<ul style="list-style-type: none">✓ Unlimited teacher groups✓ Courses with full functionality✓ Access more learning apps✓ Up to 2000 players per game (Offer applies to first year)
€0 per teacher per month	€3 per teacher per month €36 billed annually	€6 per teacher per month €72 billed annually	€8 per teacher per month €96-€90 billed annually
Continue for free	Buy now Try free trial	Buy now Try free trial	Buy now Try free trial
	Cancel at any time. Trial duration: 7 days	Cancel at any time. Trial duration: 7 days	Cancel at any time. Trial duration: 7 days

Figure 6. Kahoot! Basic, Pro, Premium, Premium+

Hapi 4: Në faqen kryesore, klikoni ikonën "Create kahoot". Do t'ju ofrohen opsione të ndryshme

si krijimi nga e para ose përdorimi i ndonjë modeli të vlerësimit formativ ose përmbledhës.

Klikoni në "New Kahoot" dhe filloni të shtoni pyetjet tuaja. Meqenëse ne përdorim versionin bazik falas, na lejohe të përdorim pyetje të tipit kuiz (MCQ) dhe të tipit të vërtetë-false. Mund të futet gjithashtu video/imazhe dhe bëni pyetje përkatëse në lidhje me to. Ka mundësi për të zgjedhur kohëzgjatjen e përgjigjes për secilën pyetje dhe vendosjen e pikëve për secilën pyetje.



Hapi 5: Kur kuizi të jetë gati, mund ta provoni, ta luani dhe ta shpërndani. Është e këshillueshme që të testoni kuizin përpara se ta shpërndani tek nxënësit. Shpërndarja mund të bëhet edhe në formën e detyrave për një datë të mëvonshme. Karakteristika më e mirë është që dikush mund të shpërndajë kuizin

duke përdorur link-un përkatës ose përmes *Google Classroom*, *Microsoft Teams*, *Twitter*, *Facebook*, platformave të ndryshme arsimore etj. Ndërsa caktoni çdo kuiz kahoot, ka opsione për të zgjedhur kohëmatësin e pyetjeve, për të përzier pyetjet dhe për t'i lejuar nxënësit të shkruajnë pseudonimet e tyre .




Figure 8. Shpërndarja e kuizit tek nxënësit

Hapi 6: Nëse një mësues dëshiron të luajë kuizin pikërisht në atë moment, ai/ajo mund të klikojë butonin luaj dhe të ekzekutojë kuizin. Një avantazh tjetër i kuizit *Kahoot!* është se ai mund të luhet si në formë individuale ose në grupe.



Figure 9. Forma e kuizit: individuale apo në grup

Nëse mësuesi e paraqet kuizin për ta luajtur në kohë reale, nxënësit duhet të hyjnë në faqen e internetit duke përdorur lidhjen e përmendur në hapin 1 dhe të shënojnë kodin e shfaqur në ekranin e mësuesit të tyre. Është e nevojshme që nxënësit të shkarkojnë aplikacionin ose të regjistrohen. Pra, kursen kohë dhe redukton ndërlikimet teknologjike për nxënësit.

Pas përfundimit të një kuizi, mësuesit mund të shohin përgjigjet individuale dhe të përgjithshme. Ekziston gjithashtu një mundësi për të parë përgjigjet e sakta ose të pasakta për çdo pyetje. Mësuesit mund ta shkarkojnë raportin e përgjithshëm në një tabelë që paraqet rezultatet e nxënësve.

Overview	Final Scores	Kahoot! Summary	1 Quiz	2 Quiz	3 Quiz	4 Quiz	5 Quiz	6 Quiz	
Syprina e figurave ne rrafsh (viti II)									
Played on	16 Apr 2020								
Hosted by	agona.ll								
Played with	11 players								
Played	15 of 15								
Overall Performance									
Total correct answers (%)	32,73%								
Total incorrect answers (%)	67,27%								
Average score (points)	7276,91 points								
Feedback									
Number of responses	0								
How fun was it? (out of 5)	0								
Did you learn something?	0,00% Yes		0,00% No						
Do you recommend it?	0,00% Yes		0,00% No						
How do you feel?	● 0,00% Positive		● 0,00% Neutral		● 0,00% Negative				
Switch tabs/pages to view other result breakdown									

Figure 10. Rezultatet e kuizit në Kahoot!

Quizizz

Quizizz është një faqe interneti me akses të hapur e krijuar në 2015 nga Ankit Gupta dhe Deepak Joy Cheenath. Përdoret si një mjet vlerësimi elektronik i cili i ndihmon mësuesit të krijojnë dhe të zgjedhin kuize për nxënësit. Së bashku me këtë, ai gjithashtu ofron veçorinë për të krijuar mësimë për studentët së bashku me pyetjet e kuizit dhe sondazheve dhe me një opsion të integruar të ruajtjes së të dhënave. Ofron lehtësi për të paraqitur kuizet drejtpërdrejt ose si detyrë shtëpie me një afat të caktuar.

Quizizz është një aplikacion edukativ i bazuar në lojë që sjell aktivitete me shumë lojtarë në klasa dhe i bën ushtrimet në klasë interaktive dhe argëtuese. Ndryshe nga aplikacionet e tjera edukative, *Quizizz* ka karakteristika të lojës si avatar, tema, meme dhe argëtim muzikor në procesin e të mësuarit. Ekzistojnë dy mënyra kryesore në *Quizizz*, përkatësisht modaliteti i instruktorit si krijues i kuizit, i cili mund të aksesohet përmes Quizizz.com dhe modaliteti i lojtarit, në këtë rast, është ai i nxënësve, i cili mund të aksesohet përmes www.Quizizz.com/join (Saleh, 2019). Ky aplikacion është gjithashtu i pajisur me një kohëmatës për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje; nëse një nxënës përgjigjet shpejt, nxënësi do të marrë më shumë pikë sesa nxënësit që

përgjigjen më pak (Setiyani Setiyani, Improving student's mathematical problem solving skills through Quizizz, 2020). Quizizz gjithashtu i lejon nxënësit të konkurrojnë me njëri-tjetrin dhe i motivon ata të studiojnë. Nxënësit marrin kuizin në të njëjtën kohë në klasë dhe shohin renditjen e tyre të drejtpërdrejtë në tabelën e liderëve. Megjithatë ata punojnë me pyetjet në të njëjtën kohë relativisht, është e vështirë për nxënësit të kopjojnë sepse pyetjet dhe përgjigjet jepen në mënyrë të rastësishme. Instruktorët mund të monitorojnë procesin dhe të shkarkojnë raportin kur kuizi të ketë mbaruar vlerësimin e performancës së nxënësve (Setiyani Setiyani, Improving student's mathematical problem solving skills through Quizizz, 2020).

Tani do ta paraqesim se si të krijojmë një kuiz dhe ta shpërndajmë atë duke përdorur Quizizz.

Hapi 1: Kërkoni për "Quizizz" në shiritin e kërkimit të Google. Klikoni në skedën <https://quizizz.com> siç tregohet më poshtë.

Quizizz funksionon edhe në formë aplikacioni për telefona inteligjentë dhe është lehtësisht i aplikueshëm.




Figure 11. Aplikacioni Quizizz

Hapi 2: Së pari, regjistrohuni përmes një llogarie të vlefshme e-maili. Pas regjistrimit të suksesshëm, do të drejtoheni në faqen kryesore të Quizizz.




Figure 12. Regjistrimi në Quizizz

Hapi 3: Përveç përdorimit të kuizeve të integruara, ne mund të krijojmë kuize sipas planit tonë mësimor. Për këtë, klikoni në "Instructor dashboard". Shkoni te "Create quiz". Shënoni titullin e kuizit dhe zgjidhni lëndën përkatëse.




Figure 13. Krijimi i një kuizi në Quizizz

Hapi 4: Zgjidhni llojin e pyetjes nga opsionet e dhëna (Multiple choice, Check box, Fill in the blank, Poll, Open ended, Slide).




Figure 14. Zgjedhja e llojit të pyetjes gjatë krijimit të një kuizi në Quizizz

- Le të demonstrojmë përdorimin e tij me pyetje me shumë zgjedhje. Ekranin e mëposhtëm shfaqet kur zgjidhet. Së pari, shkruani pyetjen dhe opsionet e mundshme në kutitë e dhëna. Ju gjithashtu mund të shtoni ose hiqni opsione. Vendosni një shenjë pranë përgjigjes së saktë.
- Mund të shtoni ekuacione matematikore duke klikuar skedën $f(x)$ dhe gjithashtu mund të shtoni fotografi, audio dhe video material (insert image, insert audio, insert video)
- Mund të vendoset një kohëmatës për çdo pyetje (5 sekonda deri në 15 minuta).
- Klikoni në ikonën "Save" për të ruajtur pyetjen.




Figure 15. Vendorsja e fotografive, video-materialeve, kohëmatësit gjatë krijimit të kuizit në Quizizz

Hapi 5: Klikoni në "Add a new question" për të shtuar më shumë pyetje në kuiz. Ju gjithashtu mund të përdorni bankën e integruar të pyetjeve të ofruar nga faqja e internetit duke klikuar ikonën "Teleport". Ekziston një opsion "Edit" për secilën pyetje për të përfshirë çdo ndryshim të nevojshëm.




Figure 16. Shtimi dhe ndryshimi i pyetjeve të kuizit në Quizizz.

Klikoni në skedën "Done", pasi të keni mbaruar me kuizin tuaj.

Hapi 6: Më pas, plotësoni detajet e kuizit si gjuha, klasa , privatësia dhe klikoni "Save" për të vazhduar në hapin tjetër.




Figure 17. Ruajtja e kuizit të krijuar në Quizizz

Hapi 7: Pasi të keni krijuar një kuiz, shkoni te "My library". Tani, mund të filloni një kuiz në kohë reale me nxënësit tuaj "Start a live quiz" ose me caktimin e një afati kohor për plotësim si detyrë shtëpie "Assign homework".




Figure 18. Forma e realizimit të kuizit me nxënësit: në kohë reale ose si detyrë shtëpie

Përpara se të caktoni një kuiz, duhet të shtoni një klasë nëpërmjet "Import from Google Classroom" ose "Create a class".




Figure 19. Shtimi i një klase nga "Google Classroom"

Hapi 8-Klikoni "Assign homework" më pas plotësoni afatin e caktuar dhe shtoni një klasë. Pas përfundimit të procesit, klikoni në skedën "Assign".




Figure 20. Kuizi i dhënë si detyrë shtëpie në Quizizz

Kuizi tani do t'i caktohet automatikisht klasës suaj.

Ju gjithashtu mund të gjeneroni një kod për kuize të veçanta dhe ta ndani atë me nxënësit përmes postës elektronike, Google Classroom, Microsoft Teams ose përmes platformave të tjera.




Figure 21. Shpërndarja e kuizit tek nxënësit nëpërmjet platformës

Nxënësit duhet të shënojnë atë kod të veçantë në hapësirën e dhënë dhe të klikojnë "Join" për të hyrë në kuiz.




Figure 22. Pjesëmarrja në kuiz me anë të kodit

Pasi nxënësit i dorëzojnë detyrat e tyre, ju mund të kontrolloni rezultatet e tyre duke klikuar skedën "Reports". Ai gjithashtu ofron opsione dmth. " Download excel ", " Rename report " dhe "Delete report ".

Type	Quiz name	Parti	Acc.	Code	Actions
Assigned	Operacione me numra te plote Running - started 14 minutes ago	0	0%	52050873	Edit assignment
Live	Klasa 4 Completed 2 months ago	2	83%		Assign practice
Assigned	Operacione me numra Completed 2 months ago	4	71%		Reopen
Live	Operacione me numra Completed 2 months ago	6	43%		Assign practice
Live	Thyesat kl.III-IV Completed 2 months ago	4	65%		Assign practice
Assigned	Rrumbullakimi i numrave Completed 2 months ago	1	100%		Reopen
Assigned	matematike 5 Completed 2 months ago	1	67%		Reopen
Live	matematike 5 Completed 2 months ago	3	83%		Assign practice
Live	matematike 5 Completed 2 months ago	3	19%		Assign practice
Live	Matematike 3-4 Completed 3 months ago	3	93%		Assign practice

Figure 23. Raporti i kuizit në Quizizz

#	Question	Question Type	Question Accuracy	Average Time per Question (mm:ss)	Correct	Incorrect	Unattempted	Amira (Amira)	Era (Era)	Elda C. (Elda C.)
1	Fjalja deklarative qe ka kuptim dhe merr njerin ng...	Fill-in-the-Blank	65%	00:49	21	7	4	grykim	Grykim	Grykim
2	Nese formula gjykmore fiton te gjitha vkerat e sak...	Fill-in-the-Blank	65%	00:33	21	5	6	taologji	Tautologji	Tautologj
3	Cila nga fjalite e dhena NUK eshte gjykim?	Multiple Choice	71%	00:57	23	4	5	Ana deshiron te	Ana deshiron te	Ana desh
4	Implikacioni i gjykimeve p dhe q (p->q) lexohet:	Check Box	25%	00:54	8	19	5	Nese p atehere	Nese p atehere	Nese p at
5	Dy gjykime te lidhura me lidhesen "dhe" perbejne	Fill-in-the-Blank	59%	00:34	19	8	5	konjunksion	konjunksion	Konjunksi
6	Negacioni i gjykimit 25>20 shprehet:	Multiple Choice	50%	00:24	16	11	5	25s20	25s20	25s20
7	Nese jane dhene gjykimet p: 23=6 dhe q: 63=216, v	Multiple Choice	65%	00:31	21	7	4	$\downarrow \vee T = T$	$\downarrow \vee T = T$	$\downarrow \vee T = T$
8	Nese jane dhene gjykimet p: 32=9 dhe q: 3,5<0,35,	Multiple Choice	40%	00:38	13	15	4	$T \rightarrow \downarrow = \downarrow$	$T \rightarrow \downarrow = \downarrow$	$T \rightarrow \downarrow = \downarrow$
9	operacioni i shprehur ne table qehet:	Fill-in-the-Blank	68%	01:25	22	5	5	negacion	Negacion	Negacion
10	Operacioni i dhene ne table qehet	Multiple Choice	65%	00:21	21	7	4	Ekuivalence	Ekuivalence	Ekuivaler
11	Cilet jane veprime me gjykime:	Check Box	40%	00:42	13	15	4	Disjunksioni,Ek	Disjunksioni,Eki	Disjunksi
12	Cila nga fjalite e meposhtme nuk eshte gjykim:	Multiple Choice	75%	00:24	24	5	3	Te mblidhen nu	Trapezi eshte k	Te mblidi
13	Gjykimet e sakta quhen:	Fill-in-the-Blank	56%	00:21	18	9	5	pohime	Pohime	Pohime
14	Vlera e saktetise se gjykimit "Numrat 1,2,3,5 jane	Multiple Choice	68%	00:25	22	7	3	\downarrow	\downarrow	\downarrow
15	Gjykimi i perbere qe eshte cdohere i pasakte qehet	Multiple Choice	43%	00:38	14	13	5	Kontradiksion	Kontradiksion	Kontradii
			57%	09:36	276	137	67	93%	86%	100

Figure 24. Rezultatet e detajuara të kuizit në Quizizz!

Koha e caktuar për pyetje dhe ndërveprimi në kohë reale është një veçori unike e Kahoot! dhe Quizizz, që nuk mund ti gjejmë në kuizet e Google forms dhe kuizet e MS Teams. Pra, nuk është e lehtë për nxënësit të kopjojnë. Quizizz funksionon individualisht për secilin nxënës, nuk duhet të presin që e gjithë klasa t'i përgjigjet një pyetjeje. Kahoot ofron një veçori për të diskutuar pas çdo pyetjeje. Versioni i gamifikuar i vlerësimit nga Kahoot dhe Quizizz ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në një klasë online dhe i mban ata të motivuar.

PËRPARËSITË E MJETEVE TË VLERËSIMIT ONLINE:

- Mjetet e vlerësimit online kursejnë kohë dhe para.
- Lehtësisht i aksesueshëm dhe i lehtë për t'u trajtuar. Dikush mund të përdorë telefona celularë, tablet, laptop dhe kompjuterë për të hyrë në kuiz. Studentët mund të zgjedhin pajisjen e tyre sipas komoditetit.
- Disponueshmëria falas e versioneve bazike.
- Mësuesit mund ta shkarkojnë raportin e rezultateve menjëherë pas përfundimit të vlerësimit dhe mund ta ruajnë për përdorim të mëvonshëm.
- Krijon një mjedis konkurrues miqësor në platformën online i cili motivon dhe angazhon nxënësit.
- Studentët mund të marrin rezultate të menjëhershme dhe komente mbi performancën e tyre.
- Rezulton në të nxënit efektiv nga nxënësit për shkak të përfshirjes së më shumë se një shqisë.

MANGËSITË E MJETEVE TË VLERËSIMIT ONLINE:

Në mënyrën online të mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, lidhja me internetin është një problem madhor si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit.

- Mungesa e mjeshtërisë të mësimdhënësve për të trajtuar këto mjete online.
- Një numër i kufizuar nxënësish mund të akomodohen dhe janë të kufizuara veprimet e disponueshme në versionin bazë falas të këtyre mjeteve.
- Mësuesit nuk mund të kontrollojnë keqpërdorimet e nxënësve.
- Duke qenë se disa nxënës nuk janë të vetëdijshëm për përdorimet e këtyre mjeteve, atyre u duhet kohë që të përshtaten,
- Gjatësia e kufizuar e karaktereve në formulimin e pyetjeve.

Edhe pse ka disa disavantazhe, përfitimet i tejkalojnë ato. Kuizet të bazuara në lojëra jo vetëm që do të tërheqin vëmendjen e nxënësve, por gjithashtu do t'i motivojnë ata. I lejonjnë instruktorët të kryejnë mësim në celular, d.m.th. ata mund të marrin vlerësime në çdo vend, në çdo kohë dhe të regjistrojnë rezultatet menjëherë. Këto mjete të mësimi elektronik na mundësojnë të përhapim arsimin përtej katër mureve të një klase. Disa shtesa të këtyre teknologjive janë rrënjësore e energjisë pozitive në mesin e nxënësve, eksplorimi i koncepteve të reja dhe përfshirja e një masë argëtimi në klasë. Pra, le të bëhemi më të zgjuar dhe pak më të dixhitalizuar duke përzier teknologjitë e e-mësimi me ato tradicionale, sepse teknologjia në duart e mësuesve mund të jetë transformuese.

2.2. Modeli Gamification

Shkollimi tradicional perceptohet si joefektiv dhe i mërzitshëm nga shumë nxënës. Edhe pse mësuesit vazhdimisht kërkojnë qasje të reja mësimore, është vërejtur kryesisht se shkollat e sotme ballafaqohen me probleme të mëdha rreth motivimit dhe angazhimit të nxënësve (Hammer, 2011). Përdorimi i lojërave edukative si mjete mësimore është një qasje premtuese për shkak të aftësive të lojërave për të mësuar dhe për faktin se ato përforcojnë jo vetëm njohuri por edhe aftësi të rëndësishme si zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi dhe komunikimi.

Fushë me interes të madh hulumtimi kohëve të fundit është procesi i ashtuquajtur *gamification* ku kërkohet që të implementohen sisteme që përmes lojës të nxisin fëmijët të mësojnë më tepër. Lojërat mund të jenë një motivues shumë i fortë për studentët kur elementët e njëjtë të lojës aplikohen në një kontekst mësimor. Kështu, disa mësues kanë miratuar konceptin e *gamification*, ku struktura e lojërave zbatohet në një kontekst të ndryshëm nga lojërat.

— Metoda statistikore kjo metodë do të na mundësojë që të gjithë të dhënat e grumbulluara të cilat do të jenë në formë të numrave ti lexojmë dhe ti paraqesim për të interpretuar rezultatet. Me anë të metodave statistikore do të shohim pikërisht të arriturat e nxënësve kur mësimi zhvillohet në formë tradicionale krahasuar me mësimin e zhvilluar me ndihmen e modelit *gamification*. Qëllimi i kësaj metode do të jetë që nëpërmjet pyetësorëve dhe analizës statistikore të rezultateve të nxënësve ndër vite të vlerësohet suksesi i zbatimit të *gamification* në një grup pilot nxënësish.

4.2. Shfrytëzimi i platformës arsimore

Platformat arsimore paraqesin sisteme elektronike për menaxhim me përmbajtjet mësimore, që përdoren nëpër shkolla për zhvillimin e lëndëve në formë elektronike. Janë faktor kyç për zhvillimin e e-mësimit. LMS-të janë teknologji të bazuara në ueb që ofrojnë për mësimdhënësit dhe studentët mundësi për të shkëmbyer materiale, për të dorëzuar detyra si dhe për t'u lidhur dhe për të biseduar në internet (Teasley, 2009). Me fjalë të tjera, një LMS ofron një dosje në internet për menaxhim të lëndës, ku mësimdhënësi mund të postojë materialet mësimore dhe detyrat derisa nxënësit të

kenë akses në përmbajtjen mësimore, dorëzojnë detyrat si dhe të marrin pjesë në çdo aktivitet tjetër mësimor online (në distancë).

Praktikat ekzistuese të sistemeve për menaxhim me mësimin dhe përdorimi i tyre paraqesin një praktikë të rëndësishme në aspektin arsimor dhe teknologjik.

Implementimi i platformës arsimore përfshin të gjitha elementet në lidhje me të nxënit, mësimdhënien, komunikimin, krijimin dhe menaxhimin. Është një proces i planifikuar që kërkon aftësi dixhitale, kompetenca dhe teknika të hartimit të lëndës dhe udhëzimit të lëndës, metodat e komunikimit përmes teknologjive elektronike dhe të tjera. Megjithatë këto sisteme me një fokus të qartë tek gamification aktualisht janë të rallë.

4.2.1. Mësimi në distancë me zbatim të platformës arsimore

Të mësuarit në distancë me zbatim të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit u bë i domosdoshëm sidomos me shpalljen e gjendjes pandemike në të gjithë botën. Shumica e punëve administrative filluan të kryhen në formë elektronike, të punuarit prej në shtëpi për të shmangur kontaktin fizik në punë. Në mënyrë të veçantë nëpër shkolla, nevoja për të zhvilluar mësimin në distancë ishte shumë e shpejtë dhe e papritur.

Edhe pse zbatimi i TIK në procesin mësimor nuk ishte diçka e re në vendin tonë, mësimi në distancë i gjeti të vënë në vështirësi një pjesë të mësimdhënësve për mungesë të përvojës dhe trajnimeve të nevojshme për zhvillimin e mësimit në distancë. Kjo vështirësi u bë edhe më komplekse nga mungesa e kushteve të nevojshme të një numër i madh i nxënësve, të cilët u kyçën në procesin mësimor pas disa orësh mësimore të humbura.

Ishte ky momenti kur procesi mësimor do të cilësohej si i dështuar pa zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Fillimisht filluan të zbatohen platformat arsimore që ishin pa pagesë varësisht prej zgjedhjes së mësimdhënësve dhe nxënësve sipas përshtatjes. Për të vazhduar të avancohen pasi filluan në masë të madhe të zhvillohen trajnime në distancë që zhvillimi i mësimit në distancë me zbatim të platformave arsimore dhe teknikave adekuate për mësim dhe vlerësim të ishte sa më efektiv.

Pasi zhvillimi I mësimit në distancë u bë pjesë e domosdoshme e shkollave fillore dhe të mesme në vendin tonë u ndërmorrën hapa për krijimin e një platforme nacionale për mësim në distancë që nuk rezultoi e efektive për arsye të problemeve teknike. Mësimi në distancë vazhdoi të zhvillohet me ndihmën e platformës ndërkombëtare “Microsoft Teams” pas një sërë trajnimesh të zhvilluara me mësime të ndihmës dhe koordinatore të përkatës.

Për nxënësit e shkollave të mesme të mësuarit prej në shtëpi ishte diçka e re. Vetë mjedisi “arsimor” në shtëpi është I ndryshëm dhe më pak tërheqës se ai në klasë. Për këtë arsye që nxënësit të ndjehen aktiv dhe të dobishëm ishte e nevojshme kyçja e teknikave adekuate që mësimi të jetë tërheqës dhe efektiv për nxënësit.

Inkuadrimi I modelit “gamification” ishte diçka e re për nxënësit që ndoshta do ti aktivizonte ato nga shtëpia që të jenë më të vëmëndshëm gjatë zhvillimit të mësimit.

Mësimi do të funksiononte në mënyrë të tillë që:

Zhvillohet njësia mësimore në Microsoft Teams.

Mësimi është interaktiv, në monitor mund të paraqiten pyetje të ndryshme në lidhje me mësimin që nxënësit do tu duhet të përgjigjen.

Në fund të çdo ore do të zhvillohet kuiz i shkurtër përmbledhës për njësinë mësimore.

Të arriturat e nxënësve në çdo orë do të evidentohen.

Nxënësit do të “shpërblehen” për të arriturat e tyre të vazhdueshme.

Orët mësimore që përfshijnë ushtrime do të zhvillohen me ndihmën e aplikacioneve “Kahoot” dhe “Quizizz” në forma të ndryshme, herë individualisht, herë në çifte dhe grupe.

Testet e parapara sipas plan programit mësimor gjithashtu do të zhvillohen në formë të kuizeve.

Ky ishte një rast i zbatimit të tekninkës gamification për mësim në distancë, megjithatë ky model është lehtësisht i zbatueshëm në klasë nëse mjetet teknologjike janë të përshtatshme.

4.3. Mbledhja e të dhënave për hulumtim

Hulumtimet në këtë punim janë kryer në bazë të disa pyetësorë drejtuar nxënësve dhe mësimdhënësve në shkolla të mesme te Maqedonisë Veriore përfshirë: SH.M.K “28 Nëntori”- Dibër, SH.M.K “Niko Nestor”-Strugë, SH.M.Q.SH. “Zef Lush Marku’- Shkup, SH.M.Q.SH “Saraj”, SH.M.EK “8 shtatori”- Tetovë, SH.M.K.M”Nikolla Shtejn” –Tetovë, SH.M. “Kiril Pejçinoviç”- Tetovë, SH.M.K “Drita”- Kërçovë, SH.M.K “7 Marsi” – Tetovë.

Pyetësori I drejtuar nxënësve përfshin zbatimin e TIK dhe modelin gamification në procesin mësimor.

Pyetësori II drejtuar mësimdhënësve përfshin kushtet për zbatim të TIK dhe modelet e reja të mësimdhënies që burojnë nga TIK bashkë me modelin gamification në procesin mësimor.

Pyetësori III drejtuar nxënësve në lidhje me lëndën e matematikës, angazhimin, motivimin dhe metodat e duhura që kjo lëndë të jetë tërheqëse për nxënësit.

Pyetësori IV i krijuar në formë të intervistës për mësimdhënës të matematikës që ka zbatuar modelin gamification.

Fillimisht janë pregaditur pyetësorët për nxënës dhe mësimdhënës në lidhje me aplikimin e TIK në mësim, përdorimin e modelit gamification, ndikimi i këtij modeli në motivimin dhe arritjet e nxënësve dhe rezultatet që do ti arrijnë ato me përdorimin e këtij modeli në lëndën e matematikës.

Më pas është kryer eksperimenti në platformat që e zbatojnë modelin gamification. Janë krahasuar rezultatet e nxënësve të vitit të I dhe të III te realizuar në formë tradicionale dhe me zbatim të modelit gamification me platformat *Kahoot!* dhe *Quizizz*.

4.3.1. Pyetësorët: I, II, III.

Zbatimi i TIK dhe modelit gamification në procesin mësimor (Pyetësor I – për nxënësit)

Pyetësi për nxënësit përfshin disa pyetje drejtuar nxënësve të shkollave të mesme për zbatimin e teknologjisë në procesin mësimor, kushtet që ofrojnë shkollat e tyre, atmosferën mësimore që krijohet në klasë, zbatimin e modelit gamification, ndikimi i këtij modeli në angazhimin, motivimin dhe të arriturat e nxënësve etj.

Zbatimi i Teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në procesin mësimor në vendin tonë është i detyrueshëm në të gjitha lëndët, në 30% të orëve mësimore të planifikuara sipas plan-programit mësimor të vitit shkollor përkatës. Zhvillimet e shpejta teknologjike kanë ndikuar edhe në arsim, por qëllimi është që të gjenden modele mësimore që përmes shrytëzimit të teknologjisë nxënësit të mësojnë më tepër dhe të arrijnë rezultate më të mira.

Bazuar në këtë është krijuar pyetësi I të cilit i janë përgjigjur nxënësit.

Zbatimi i TIK dhe modeleve elektronike të mësimdhënies (Pyetësi II – për mësimdhënësit)

Pyetësi i dytë u drejtohet mësimdhënësve të shkollave të mesme. Përfshin pyetje mbi përshtatjen e tyre me zbatimin e TIK në procesin mësimor, kushtet që ofrojnë shkollat ku ata punojnë, vështirësitë që hasin gjatë zbatimit të TIK në lëndët e tyre mësimore, investimi në kohë që ata bëjnë për ta zbatuar atë siç duhet, njohuritë që ata kanë për modelin gamification, aftësitë për zbatimin e platformave arsimore sipas kërkesave teknologjike bashkëkohore dhe të ngjajshme.

Lënda e matematikës dhe vështirësitë për ta mësuar atë (Pyetësi III – për nxënësit)

Pyetësi i tretë është gjithashtu për nxënësit por përfshin pyetje mbi lëndën e matematikës, vështirësitë për ta mësuar atë, mungesa e motivimit që i pengon ata për të avancuar në këtë lëndë, metodat mësimore që e bëjnë këtë lëndë më tërheqëse dhe efektive për nxënësit, zbatimi i TIK në matematikë, inkuadrimi i modelit gamification dhe aplikacioneve që e zbatojnë atë e të tjerë.

Mësimdhënia bashkëkohore mbi lëndën e matematikës e aktualizon aktivitetin e nxënësit, si një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e tij. Nga kjo rrjedh se parakusht për

praktikë të suksesshme mësimore në lëndën e matematikës është përcaktimi i aktiviteteve të cilat do të mundësojnë stimulim pozitiv në zhvillimin e çdo nxënësi.

4.3.2. Implementimi i modelit gamification në lëndën e matematikës (intervistë)

Një pyetësor në formë të intervistës është krijuar për një mësimdhënës të matematikës që zbaton TIK dhe modelin gamification gjatë orëve mësimore. Në vijim janë paraqitur pyetjet e parashtruara dhe përgjigjet që u përkojnë atyre.

Pyetjet nga intervista	Përgjigjet e mësimdhënësit të matematikës
1. Ju lutem përshkruani përvojën tuaj të përdorimit të modelit "gamification" në lëndën e matematikës	Nga zbatimi i domosdoshëm i TIK në arsim u paraqit nevoja për gjetjen e modeleve të reja të mësimdhënies në formë elektronike. Si model i rallë por bashkëkohor, modeli "gamification" pati ndikimet e tij në shumë sfera. Në lëndën e matematikës që nga prezentimet dhe video-materialet në formë elektronike filloi të rritet interesimi i nxënësve. Nxënësit dukshëm ishin më të motivuar kur në ushtrimet matematikore i inkuadruam lojërat në formë kuizesh me aplikacione që i ofronin ato. Njohuritë e tyre matematikore treguan rezultate më të mira se ato në formën klasike të ushtrimeve.
2. Cilët faktorë kanë ndikuar në integrimin e modelit "gamification" në zhvillimin e lëndës së matematikës në klasë?	Mugesia e motivimit dhe interesimit të një numër i madh i nxënësve, rezultatet e dobëta që ata arrinin në ushtrime dhe testet e zhvilluara në formë tradicionale janë faktorët kryesorë që më çuan në kërkim të modeleve të reja të mësimdhënies. Ndër to gjeta disa udhëzime mbi modelin "gamification" dhe vendosa ta provoj integrimin e këtij modeli në lëndën e matematikës.
3. Ju lutem, përshkruani përshkrimin tuaj të parë në lidhje me modelin "gamification" kur u prezantuat për herë të parë.	Kur u prezantova me modelin "gamification" nëpërmjet trajnimeve bazike online më dukej interesant por nuk isha e sigurt nëse zbatimi i këtij modeli në lëndën e matematikës me nxënës të shkollave të mesme ishte ide e mirë, derisa vendosa ta provoj në formë eksperimentale.
4. Ju lutemi, përshkruani se si ndiheshit për modelin "gamification" pas integritimit në mësimin tuaj të matematikës për herë të parë.	Pasi vazhduam ta zbatojmë modelin "gamification" në orët mësimore të matematikës, nxënësit filluan të adaptohen dhe ta shijojnë atë. Karakteri garues i ushtrimeve në formë kuizesh shtoi interesimin e nxënësve për lëndën e matematikës. Ata përqëndroheshin më shumë dhe ishin të vëmendshëm që të mbajnë mend konceptet dhe të fitojnë pikë maksimale në lojëra dhe kuize
5. Sa kohë keni përdorur gamification në mësimet tuaja të matematikës?	Po bëhen 5 vite që e përdor vazhdimisht modelin "gamification" në orët mësimore të matematikës me ndihmën e aplikacioneve që e mundësojnë zbatimin e këtij modeli.

6. Si ndiheni tani për modelin gamification pasi e keni përdorur atë me kalimin e kohës?	Unë dhe nxënësit jemi përshtatur shumë mirë me modelin "gamification". Ushtrimet matematikore janë më interesante për nxënësit dhe rezultatet e tyre janë përmirësuar dukshëm. Ky sukses e bën edhe punën time më të bukur edhe pse shpesh kërkon investim më të madh në kohë.
7. Çfarë qëndrimesh apo perceptimesh personale kanë ndryshuar që kur e keni përdorur modelin "gamification" me kalimin e kohës?	Duke mos përjashtuar modelin tradicional në mësimdhënien e matematikës, mendoj se inkuadrimi i modelit "gamification" po tregon sukses në të arriturat e nxënësve dhe interesimin e tyre për lëndën e matematikës.
8. Çfarë lloje të mjeteve të modelit "gamification" përdorni me nxënësit tuaj?	Aplikacionet që e ofrojnë këtë model falas dhe po përshtaten shumë mirë nxënësit janë Kahoot! dhe Quizizz. Megjithatë përdorim edhe aplikacione të tjera që i ofrojnë platformat arsimore kur mund të gjejmë qasje tek ato.
9. Si ka ndikuar modeli "gamification" në mësimdhënien tuaj?	Mendoj se ka ndikuar pozitivisht, duke u bazuar në arritjet e nxënësve dhe përshtypjet e tyre motivuese për lëndën e matematikës.
10. Si e ndryshuat vlerësimin tuaj të nxënësve për të arriturat kur integruat modelin "gamification" në lëndën e matematikës?	Fillimisht ofrova mënyrën e vlerësimit që ishte më e përshtatshme për nxënësit. Ato mund të zgjedhin nëse duan të përgjigjen në formë tradicionale ose me zbatim të metodave elektronike duke përfshirë edhe modelin gamification. Pastaj vlerësimi i përgjithshëm bëhet me një mesatare të të arriturave të nxënësve në të gjitha format dhe modelet e kombinuara gjatë procesit mësimor të matematikës.
11. Ju lutem përshkruani se si i angazhoni nxënësit me modelin "gamification" në mësimet tuaja të matematikës?	Pasi jap sqarimet dhe udhëzimet e nevojshme për njësinë mësimore përkatëse dhe nxënësit mbajnë shënime ose ndjekin prezantimin. Duhet të jenë të vëmendshëm që të përgjigjen saktë në ushtrimet që pasojnë në lidhje me njësinë përkatëse në lojën në formë të kuizit. Nxënësit që arrijnë ti kryesojnë 3 vendet e para shpërblehen. Këto janë pikë të shtuara pozitive edhe në listën evidentuese për të arriturat e nxënësve.
12. A keni gjetur ndonjë ndryshim në mësimin e nxënësve duke përdorur modelin gamification?	Po, është rritur interesimi për lëndën e matematikës, nxënësit janë më të vëmendshëm gjatë ligjërimit dhe prezentimit të njësive mësimore, janë më bashkëpunues me njëri-tjetrin dhe rezultatet e tyre janë më të mira.
13. Si e perceptoni përdorimin e modelit gamification në mësimin tuaj të matematikës?	Motivues dhe të suksesshëm. Numrat, ekuacionet, funksionet, format gjeometrike duken më interesante për nxënësit në një monitor se të shënuara në tabelë.

<p>14. Përshkruani se si nxënësit e perceptojnë përdorimin e modelit gamification në mësimet tuaja të matematikës?</p>	<p>Mendoj se është modeli mësimor që ato kërkojnë ta zbatojnë pothuajse çdo orë për shkak se nxit karakterin garues, rrit vetëbesimin dhe dëshirën për të kryesuar listën me pikë maksimale.</p>
<p>15. Ju lutem përshkruani çdo zhvillim profesional që keni marrë duke përdorur modelin gamification.</p>	<p>Modeli "gamification" ka inicuar tek unë hulumtimin e aplikacioneve që e zbatojnë atë duke bërë që të ndjek modelet e reja elektronike që janë të përshtatshme për procesin mësimor.</p>
<p>16. Çfarë problemesh teknike keni hasur kur përdorni modelin gamification?</p>	<p>Problemi i vetëm që mund të kemi hasur gjatë zhvillimit të kuizeve ka qenë shkëputja e rrjetit në internet, por edhe kjo ka ndodhur ralle herë.</p>
<p>17. Çfarë do t'u sugjeronit sistemeve shkollore që kërkojnë të zbatojnë modelin "gamification" në procesin mësimor?</p>	<p>Ju sugjeroj që fillimisht të pajisen me mjetet e nevojshme teknologjike, internet të shpejtë dhe cilësor. Të trajnojnë vazhdimisht mësimdhënësit në lidhje me këtë model dhe aplikacionet që e zbatojnë atë në procesin mësimor.</p>
<p>18. Çfarë sugjerimesh keni për një koleg të interesuar për të integruar modelin "gamification" në orën e matematikës?</p>	<p>Për arsye se lënda e matematikës cilësohet si e vështirë dhe e pakapshme për një pjesë të nxënësve, mendoj se modeli "gamification" e bën atë më interesante dhe motivuese për ato. Prandaj, disa elemente të këtij modeli duke inkuadruar kuizet matematikore parapakisht të pregaditura në Kahoot! do ti motivojnë nxënësit që të tregojnë rezultate më të mira.</p>

4.3.3. Testim në lëndën e matematikës në formë tradicionale dhe elektronike

Në lëndën e matematikës testi u zhvillua në formë elektronike dhe në formë tradicionale.

Pjesa e parë e testimit

Në pjesën e parë të testimit u krahasuan të arriturat e nxënësve në formë tradicionale, me laps dhe letër dhe në testin me të njëjtën përmbajtje që u zhvillua me ndihmën e aplikacioneve Kahoot! dhe Quizizz.

Testi përfshin pyetje dhe detyra nga matematika për vitin e III, tema mësimore : Gjeometria analitike.

Në testin e zhvilluar me platformën Kahoot! u parashtruan 15 pyetje. U hulumtuan rezultatet e arritura të nxënësve të një klase në formë elektronike, secila pyetje ka pikët dhe kohën e kufizuar për përgjigje.




Figure 30. Saktësia/pasaktësia e përgjigjeve të nxënësve në Kahoot! e shprehur në përqindje.



Correct answers

25%

Avg. answers time

23.54s

Players answered

20 of 20

				Player	
Ardita		3		Incorrect	17.5s
Ariton		4		Incorrect	4.3s
Arti		5		Correct	30.4s
Aurora		7		Incorrect	29.5s
Dafina		3		Incorrect	21.7s
Eduard		5		Correct	14.2s
Egzon		4		Incorrect	19s

Figure 31. Përgjigjet e detajuara të nxënësve në pyetjen e testit në Kahoot!

Table 1. Pikët e fituara nga nxënësit në testin në formë kuizi në Kahoot!

	Total Score (points)	Correct Answers	Incorrect Answers
	11365	10	5
	11346	10	5
	7763	8	7
	7715	7	8
	7435	6	9
	7136	7	8
	6063	7	8
	5778	7	8
	5706	3	12
	5540	6	9
	5453	5	10
	5140	5	10
	5060	5	10
	4614	5	10
	4578	6	9
	4222	5	10
	3924	4	11
	2520	3	12
	2429	3	12
	663	1	14

Në provimin e zhvilluar në formë elektronike me aplikacionin Quizizz u parashtruan 22 pyetje , secila prej tyre kishte kohën e caktuar për zgjidhje dhe përgjigje. Të gjitha detajet në lidhje me saktësinë, kohën e përgjigjes për çdo nxënës në veçanti e paraqet raporti që përpunohet automatikisht pas përfundimit të kuizit.

Questions


No.	Question	Time	Accuracy	Responses			
				Correct	Incorrect	Unattempted	Timed Out
1	Sistemi kenddrejte koordinativ ne rrafshin π shenohet:	30 secs	72%	16	6	0	0
2	Ne sistemin kenddrejte koordinativ (O, \vec{i}, \vec{j}) pika $A(2, -5)$ e zberthyer sipas rreze vektoreve do te shenohet:	33 secs	63%	14	8	0	0
3	Koordinatat e vektorit \vec{AB} ,nese $A(3, -4)$ dhe $B(5, 6)$ janë:	33 secs	81%	18	4	0	0
4	Ndryshimi i vektoreve $\vec{a} = (2, 0)$ dhe $\vec{b} = (-1, -4)$ do te jete:	27 secs	90%	20	2	0	0
5	Gjatesia e vektorit a te dhene me $\vec{a} = (\sqrt{11}, -\sqrt{5})$ do te jete:	33 secs	63%	14	8	0	0
6	Barazimi i shprehur me $y - y_1 = \frac{y_2 - y_1}{x_2 - x_1} (x - x_1)$ quhet:	23 secs	72%	16	6	0	0
7	Koordinatat e pikes,e cila segmentin e dhene $A(x_1, y_1)$ dhe $B(x_2, y_2)$ e ndan ne raport $m : n = \lambda$, caktohet me formulat:	40 secs	63%	14	8	0	0
8	Koordinatat e mesit te segmentit me pikat e skajshme A(5,7) dhe B (7,5) do te jene:	30 secs	68%	15	7	0	0

9	Dy drejteza te dhena me $A_1 x + B_1 y + C_1 = 0$ dhe $A_2 x + B_2 y + C_2 = 0$ jane paralele dhe te ndryshme nese:	30 secs	68%	15	7	0	0
10	Drejtezat e dhena me barazimet : $p : 3x - 2y - 7 = 0$ dhe $q : 6x - 4y - 10 = 0$	28 secs	86%	19	3	0	0
11	Nese koeficientet e drejtezave jane : $k_1 = 7$ dhe $k_2 = \frac{3}{4}$ atehere kendi ndermjet tyre do te jete:	30 secs	72%	16	6	0	0
12	Nese pika $C(p, q)$ eshte qendra e vijes rrethore, kurse r rrezja, dhe $p = q = 0$ atehere barazimi i vijes rrethore do te jete:	27 secs	77%	17	5	0	0
13	Barazimi i vijes rrethore qe kalon neper piken $M(7, -3)$, kurse qendra eshte ne vijen rrethore $C(3, 0)$ do te jete:	42 secs	68%	15	7	0	0
14	Barazimi i vijes rrethore te dhene ne formen e pergjithshme jepet me barazimin:	38 secs	95%	21	1	0	0
15	Cakto poziten e drejtezes $x + y - 9 = 0$ dhe vijes rrethore $(x - 2)^2 + (y - 1)^2 = 25$	47 secs	72%	16	6	0	0
16	Gjysemboshtet a, b te elipses te dhene me barazimin $9x^2 + 25y^2 = 900$ jane:	33 secs	81%	18	4	0	0
17	Kordinatat e fokuseve te elipses te dhene me $\frac{x^2}{100} + \frac{y^2}{36} = 1$ do te jene:	30 secs	68%	15	7	0	0
18	Barazimi i tangjentes se elipses $5x^2 + 20y^2 = 100$ ne piken $M(2, 2)$ do te jete:	45 secs	63%	14	8	0	0
19	Nese $a = 3, b = 7$ barazimi i hiperbolles do te jete:	32 secs	59%	13	9	0	0
20	Drejteza e prek hiperbollen (eshte tangjente e saj) nese:	41 secs	77%	17	5	0	0
21	Barazimi kanonik i parabolles shprehet me fomulen:	25 secs	68%	15	7	0	0
22	Nese eshte dhene $F(-3, 0)$ Barazimi i parabolles do te jete:	37 secs	68%	15	7	0	0


Pyetjet dhe detyrat ishin të konkretizuara edhe me ilustrime si më poshtë:

Appendix - Images


1.  Sistemi kënddrejte koordinativ në rrafshin π shenohet:

7.  Koordinatat e pikës, e cila segmentin e dhënë $A(x_1, y_1)$ dhe $B(x_2, y_2)$ e ndan në raport $m : n = \lambda$, caktohet me formulat:

8.  Koordinatat e mesit të segmentit me pikat e skajshme A(5, 7) dhe B(7, 5) do të jete:


9.  Dy drejtesa të dhena me $A_1x + B_1y + C_1 = 0$ dhe $A_2x + B_2y + C_2 = 0$ janë paralele dhe të ndryshme nëse:

12.  Nëse pika $C(p, q)$ është qendra e vijes rrethore, kurse r rrezja, dhe $p = q = 0$ atëherë barazimi i vijes rrethore do të jete:

13.  Barazimi i vijes rrethore që kalon nëpër pikën $M(7, -3)$, kurse qendra është në vijën rrethore $C(3, 0)$ do të jete:


14.  Barazimi i vijes rrethore të dhënë në formën e përgjithshme jepet me barazimin:

15.




Cakto poziten e drejtezes $x + y - 9 = 0$ dhe vijes rrethore $(x - 2)^2 + (y - 1)^2 = 25$

16.




Gjysemboishtet a, b te elipses te dhene me barazimin $9x^2 + 25y^2 = 900$ jane:

17.




Kordinatat e fokuseve te elipses te dhene me $\frac{x^2}{100} + \frac{y^2}{36} = 1$ do te jene:

18.




Barazimi i tangjentes se elipses $5x^2 + 20y^2 = 100$ ne piken $M(2, 2)$ do te jete:

19.




Nese $a = 3, b = 7$ barazimi i hiperbolles do te jete:

20.



Drejteza e prek hiperbollen (eshte tangjente e saj) nese:

21.



Barazimi kanonik i parabolles shprehet me fomulen:

Figure 33. Pyetjet dhe detyrat e testit me ilustrime në Quizizz

Rezultatet që i arritën nxënësit do të paraqiten në figurën vijuese.

Avg. Time	Score	Accuracy	Correct	
21 secs	22330	100%	22 / 22	
26 secs	21750	100%	22 / 22	
27 secs	21460	100%	22 / 22	
30 secs	21450	100%	22 / 22	
58 secs	19680	100%	22 / 22	
36 secs	19610	95%	21 / 22	
26 secs	18720	95%	21 / 22	
61 secs	17740	95%	21 / 22	
26 secs	17320	91%	20 / 22	
43 secs	17300	95%	21 / 22	
28 secs	15220	82%	18 / 22	
44 secs	12980	82%	18 / 22	
56 secs	12330	77%	17 / 22	
40 secs	11690	77%	17 / 22	
33 secs	9910	64%	14 / 22	
66 secs	9160	64%	14 / 22	
15 secs	8460	45%	10 / 22	
55 secs	6740	45%	10 / 22	
10 secs	6250	32%	7 / 22	
10 secs	5470	27%	6 / 22	
9 secs	3540	18%	4 / 22	
15 secs	3480	18%	4 / 22	

Figure 34. Rezultatet e nxënësve të vititi të III në test në Quizizz.

Table 2. Rezultatet e detajuara të nxënësve të vititi të III në test në Quizizz.

Last Name	Attempt #	Accuracy	Score	Correct	Incorrect	Unattempted	Total Time Taken
Ambari	22	100 %	22330	22	0	0	07:24
kuka	22	100 %	21750	22	0	0	09:13
Okshe	22	100 %	21460	22	0	0	09:39
Qormemeti	22	100 %	21450	22	0	0	10:38
m	22	100 %	19680	22	0	0	21:02
Trepca	22	95 %	19610	21	1	0	12:54
G	22	95 %	18720	21	1	0	09:11
marku	22	95 %	17740	21	1	0	22:18
Sela	22	90 %	17320	20	2	0	09:15
Spahiu	22	95 %	17300	21	1	0	15:43
Gjoci	22	81 %	15220	18	4	0	10:04
Ballanca	22	81 %	12980	18	4	0	15:56
Fejsko	22	77 %	12330	17	5	0	20:25
Kaba	22	77 %	11690	17	5	0	14:32
Shatku	22	63 %	9910	14	8	0	12:05
Veliu	22	63 %	9160	14	8	0	23:50
Sela	22	45 %	8460	10	12	0	05:26
Sejdiu	22	45 %	6740	10	12	0	20:06
	22	31 %	6250	7	15	0	03:32
Mashkulli	22	27 %	5470	6	16	0	03:21
Telqiu	22	18 %	3540	4	18	0	03:03
Tomini	22	18 %	3480	4	18	0	05:12

Në testin e zhvilluar në formë tradicionale , në klasë me laps dhe letër gjatë një ore mësimore u arritën rezultatet si më poshtë:

Table 3. Rezultatet e nxënësve në testimin me shkrim - në formë tradicionale

Numri i nxënësit	Pikët e fituara në %	Nota	Kohëzgjatja e zgjidhjes së testit
1.	52 %	2	42 min
2.	91 %	5	45 min
3.	85 %	4	40 min
4.	89 %	4	41 min
5.	63 %	3	45 min
6.	10 %	1	30 min
7.	85 %	4	43 min
8.	55 %	2	40 min
9.	40 %	1	35 min
10.	98 %	5	45 min
11.	88 %	4	44 min
12.	77 %	4	40 min
13.	20 %	1	30 min
14.	93 %	5	45 min
15.	30 %	1	35 min
16.	90 %	5	45 min
17.	80 %	4	44 min
18.	73 %	3	45 min

19.	89 %	4	40 min
20.	66 %	3	42 min
21.	72 %	3	40 min
22.	95 %	5	45 min

Testimi i dytë

Në pjesën e dytë të testimit u krahasuan të arriturat e një grupi nxënësish në formë tradicionale, me të arriturat e grupit tjetër të nxënësve në testin me të njejtën përmbajtje por që u zhvillua në formë elektronike me ndihmën e aplikacionit Quizizz.

Testi përfshin pyetje dhe detyra nga matematika për vitin e I, tema mësimore : Logjika matematike. Gjykimet.

Rezultatet e testit në formë elektronike janë paraqitur në tre ilustrimet e mëposhtme:

Table 4. Rezultatet e grupit të dytë të nxënësve të vitit I në testin e realizuar në Quizizz.

Avg. Time	Score	Accuracy	Correct	
99 secs	9900	93%	14 / 15	
89 secs	9900	87%	13 / 15	
82 secs	9900	100%	15 / 15	
53 secs	9300	93%	14 / 15	
32 secs	8800	93%	14 / 15	
16 secs	8600	80%	12 / 15	
11 secs	8100	80%	12 / 15	
60 secs	7400	73%	11 / 15	
16 secs	7400	80%	12 / 15	
52 secs	7400	80%	12 / 15	
13 secs	7300	73%	11 / 15	
41 secs	6800	67%	10 / 15	
58 secs	6800	60%	9 / 15	
20 secs	6200	67%	10 / 15	
25 secs	6100	67%	10 / 15	
25 secs	6100	67%	10 / 15	
8 secs	6000	60%	9 / 15	
44 secs	5700	60%	9 / 15	
40 secs	5500	60%	9 / 15	
73 secs	5500	60%	9 / 15	
17 secs	5400	60%	9 / 15	
56 secs	5000	53%	8 / 15	
32 secs	4300	47%	7 / 15	
7 secs	4200	47%	7 / 15	
35 secs	4200	47%	7 / 15	
11 secs	3600	33%	5 / 15	
57 secs	3000	33%	5 / 15	

Questions

No.	Question	Time	Accuracy	Responses		
				Correct	Incorrect	Unattempted
1	Fjalja deklarative qe ka kuptim dhe merr njerën nga vlerat e saktësisë së sakte ose jo e sakte quhet	52 secs	65%	21	10	0
2	Nese formula gjykimore fiton te gjitha vkerat e sakta te saktësisë quhet:	60 secs	65%	21	8	0
3	Cila nga fjalite e dhena NUK eshte gjykim?	57 secs	71%	23	4	0
4	Implikacioni i gjykimeve p dhe q ($p \Rightarrow q$) lexohet:	52 secs	25%	8	25	0
5	Dy gjykime te lidhura me lidhesen "dhe" perbejne gjykim i cili quhet:	36 secs	59%	19	13	0
6	Negacioni i gjykimit $25 > 20$ shprehet:	27 secs	50%	16	16	0
7	Nese jane dhene gjykimet p: $2^3=6$ dhe q: $6^3=216$, vlera e tyre logjike pvq do te shprehet:	28 secs	65%	21	13	0
8	Nese jane dhene gjykimet p: $3^2=9$ dhe q: $3,5 < 0,35$, cakto vlerën logjike te gjykimit p implikacion q	35 secs	40%	13	19	0
9	operacioni i shprehur ne tabele quhet:	80 secs	68%	22	7	0
10	Operacioni i dhene ne tabele quhet	21 secs	65%	21	8	0
11	Cilet jane veprime me gjykime:	45 secs	40%	13	20	0
12	Cila nga fjalite e meposhtme nuk eshte gjykim:	25 secs	75%	24	5	0
13	Gjykimet e sakta quhen:	21 secs	56%	18	11	0
14	Vlera e saktësisë së gjykimit "Numrat 1,2,3,5 jane te thjeshte "eshte:	24 secs	68%	22	10	0
15	Gjykimi i perbere qe eshte cdohere i pasakte quhet:	41 secs	43%	14	18	0

Figure 35. Saktësia/pasaktësia e nxënësve të vitit të parë në testin në Quizizz.

Total Questions ✓ Correct × Incorrect ⓧ Unattempted ⌚ Timed Out

15

14

1

0

0

No.	Question	Time	Score	Response
1	Fjalja deklarative qe ka kuptim dhe merr njereren nga vlerat e sakte ose jo e sakte quhet	37 secs	700	✓ Gjykim
2	Nese formula gjykimore fiton te gjitha vkerat e sakta te sakte quhet:	31 secs	600	✓ Tautologji
3	Cila nga fjalite e dhena NUK eshte gjykim?	6 secs	600	✓ Ana deshiron te shkoje ne shkolle
4	Implikacioni i gjykimeve p dhe q ($p \Rightarrow q$) lexohet:	38 secs	0	✓ Nese p atehere q
5	Dy gjykime te lidhura me lidhesen "dhe" perbejne gjykim i cili quhet:	10 secs	700	✓ Konjunksion
6	Negacioni i gjykimit $25 > 20$ shprehet:	5 secs	600	✓ $25 \leq 20$
7	Nese jane dhene gjykimet p: $2^3=6$ dhe q: $6^3=216$, vlera e tyre logjike pvq do te shprehet:	46 secs	600	✓ $\perp \vee T = T$
8	Nese jane dhene gjykimet p: $3^2=9$ dhe q: $3,5 < 0,35$, cakto vleren logjike te gjykimit p implikacion q	4 secs	700	✓ $T \rightarrow \perp = \perp$
9	operacioni i shprehur ne tabele quhet:	43 secs	600	✓ Negacion
10	Operacioni i dhene ne tabele quhet	7 secs	600	✓ Ekuivalence
11	Cilet jane veprime me gjykime:	7 secs	600	✓ Negacioni × Tautologjia ✓ Disjunksioni
12	Cila nga fjalite e meposhtme nuk eshte gjykim:	7 secs	600	✓ Te mblidhen numrat 1 dhe 5
13	Gjykimet e sakta quhen:	34 secs	600	✓ Pohime
14	Vlera e sakte se gjykimit "Numrat 1,2,3,5 jane te thjeshte" eshte:	5 secs	700	✓ \perp
15	Gjykimi i perbere qe eshte cdo here i pasakte quhet:	41 secs	600	✓ Kontradiksion

Figure 36. Rezultatet e detajuara të testit të një nxënësi në Quizizz.

Rezultatet e testit në formë tradicionale me grupin tjetër të nxënësve janë paraqitur në tabelën vijuese:

Table 5. Rezultatet e testimit me shkrim të grupit të II të nxënësve të vitit I

Numri i nxënësit Grupi II	Pikët e fituara në %	Nota	Kohëzgjatja e zgjidhjes së testit
1.	64 %	3	42 min
2.	91 %	5	45 min
3.	85 %	4	40 min
4.	89 %	4	41 min
5.	77 %	4	45 min
6.	52 %	2	30 min
7.	85 %	4	43 min
8.	55 %	2	40 min
9.	52 %	2	35 min
10.	98 %	5	45 min
11.	88 %	4	44 min
12.	77 %	4	40 min
13.	20 %	1	30 min
14.	93 %	5	45 min
15.	30 %	1	35 min
16.	90 %	5	45 min
17.	80 %	4	44 min
18.	73 %	3	45 min
19.	89 %	4	40 min
20.	66 %	3	42 min
21.	72 %	3	40 min
22.	95 %	5	45 min
23.	98 %	5	42 min
24.	78 %	4	43 min
25.	77 %	4	44 min
26.	63 %	3	42 min
27.	26 %	1	30 min

4.4. Analiza e të dhënave

4.4.1. Analiza e pyetësorit I

Në pyetësorin e parë për nxënësit në lidhje me zbatimin e TIK në procesin mësimor dhe inkuadrimin e modelit gamification u përgjigjën 60 nxënës të shkollave të mesme.

Nga nxënësit që u përgjigjën në lidhje me kushtet për zbatim të TIK që i zotërojnë shkollat, 60% prej tyre pranuan se shkollat e tyre janë deri diku të pajisura me mjete teknologjike, disa nga pajisjet e nevojshme mungojnë, megjithatë 41,7% shpesh i përdorin ato. Në disa nga shkollat, problemet me internetin janë pengesë që TIK të zbatohet në mënyrën e duhur. Nga nxënësit që u përgjigjën, 50% prej tyre e konfirmuan se e përdorin TIK në lëndët e shkencave natyrore, dhe më pak në lëndët tjera.

Një pjesë e madhe e nxënësve e pranuan se teknologjia i bën lëndët më tërheqëse dhe të kuptueshme.

6. A ju ndihmon teknologjia që lëndët t'ju duken më tërheqëse dhe të kuptueshme?

60 responses




Figure 37. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

Në lidhje me mënyrën e zhvillimit të orës mësimore, shumica e nxënësve preferuan të mësonin në prezencë fizike por me inkuadrim të lojërave dhe kuizeve si pjesë të modelit gamification.

9. Sipas mendimit tim, mësimi më tërheqës dhe efektiv përkon me:

60 responses




Figure 38. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

Në lidhje me ndikimin e teknologjisë në shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, nxënësit mendojnë si më poshtë:

11. Si mendon, cilat veti janë përmirësuar tek ti që nga inkuadrimi I teknologjisë në procesin mësimor? (Mund të selektoni me shumë se një përgjigje)

60 responses




Figure 39. Përfaqësimi në përqindje I secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

Kahoot! dhe *Quizizz* janë aplikacionet për kuize që përdoren më shumë nëpër klasat e tyre. Dhe për shumicën e nxënësve ora mësimore me zbatim të kuizeve dhe lojërave me karakter garues është më interesante. Megjithatë, modeli *gamification* si koncept edukativ akoma nuk është plotësisht i njohur. Ka nga ata nxënës që edhe pse i preferojnë lojërat dhe kuizet termi *gamification* u duket i panjohur.

13. Cilin nga aplikacionet e përdorni për kuize?

60 responses




Figure 40. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

14. A ju duket ora mësimore më interesante kur mësimdhënësi ju vlerëson me anë të kuizeve dhe lojërave me karakter garues?

60 responses



Figure 41. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

Nxënësit veçojnë lëndën e gjuhës angleze si më të përshtatshme për të zbatuar modelin gamification, duke u bazuar në suksesin që ata kanë arritur nëpër kuizet e gjuhës angleze. Megjithatë, sa u takon testeve kontrolluese shumica e nxënësve e shohin më të përshtatshëm atë në formë tradicionale, me laps dhe letër.

15. Rrethoni opsionin më të përshtatshëm për zhvillimin e testeve sipas mendimit tuaj:
60 responses



Figure 42. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

Një pjesë e madhe e nxënësve kanë vlerësim të veçantë për orën mësimore kur inkuadrohen lojëra në të. Nxënësit angazhohen dhe janë më të motivuar për mësim. Ata e ndjejnë veten më kreativë dhe bashkëpunues me njëri – tjetrin. Nga përgjigjet e tyre është vënë në dukje se vetëbesimi i nxënësve është rritur dhe aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve mësimore janë përmirësuar, duke ndikuar gjithashtu edhe në shkathtësitë digjitale të tyre.

19. Sipas mendimit tim, orën mësimore kur përdorim aplikacione me lojëra arsimore e vlerësoj:
60 responses




Figure 43. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit I.

4.4.2. Analiza e pyetësorit II

Në pyetësorin e dytë janë përgjigjur 50 mësimdhënës të shkollave të mesme në vendin tonë, të moshës nga 23 deri në 60 vjet, ku pjesa më e madhe e tyre kanë 11-20 vjet përvojë pune në arsim. Një pjesë e madhe e tyre pohojnë se janë përshtatur shkëlqyeshëm me zbatimin e TIK në procesin mësimor dhe i kanë tejkaluar vështirësitë.

Në vitet e fundit zbatimi i TIK në arsim është bërë i domosdoshëm në 30% të orëve mësimore sipas planprogramit përkatës. Si po përshatani me zbatimin e TIK në lëndën tuaj?

50 responses



Figure 44. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit II.

Prej mësimdhënësve të anketuar, vetëm 10 % nuk kanë komunikim të vazhdueshëm në distancë me platforma arsimore.

Shumica prej tyre theksojnë që problemet me internetin e pengojnë zbatimin e plotë të TIK në procesin mësimor.

Pjesa më e madhe e tyre janë përgjigjur se inkuadrimi i TIK në procesin mësimor ka ndikuar pozitivisht në angazhimin e nxënësve, motivimin dhe bashkëpunimin me njëri tjetrin. Ata janë të vëmendshëm dhe të saktë në përgjigje. Ndërsa një pjesë e vogël e mësimdhënësve e kanë kundërshtuar këtë fakt me përgjigjet e tyre.

Gjatë realizimit të orëve me TIK mendoj se nxënësit janë:

50 responses




Figure 45. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit II.

Të gjithë mësimdhënësit që iu përgjigjën anketës pohuan se përdorin aplikacione me kuize dhe lojëra me karakter garues. Shumica prej tyre kanë përdorur aplikacionin Kahoot! për ushtrime në formë kuizesh.

Njësoj si nxënësit edhe mësimdhënësit pajtohen se mësimi është më efektiv dhe tërheqës kur zbatohen lojëra me karakter garues. Përgjigjet e tyre janë paraqitur në diagramin sektorial të paraqitur më poshtë.

A mendoni se mësimi është më efektiv dhe tërheqës për nxënësit kur zbatoni lojëra-kuize me karakter garues?
50 responses



Figure 46. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetësi II

Pjesa më e madhe e mësimdhënësve e zbatojnë modelin gamification dhe i shfrytëzojnë aplikacionet që e zbatojnë atë, në veçanti Kahoot! dhe Quizizz. Vetëm disa prej tyre e shohin këtë model jo të përshtatshëm për lëndën që ligjërojnë.

Një pjesë e mësimdhënësve e pranojnë faktin që zbatimi i TIK në procesin mësimor kërkon investim më të madh në kohë nga ana e tyre në krahasim me mënyrën tradicionale të mësimdhënies, por angazhimi, motivimi dhe bashkëpunimi ndërmjet nxënësve është rritur dukshëm. Lojërat dhe kuizet me karakter garues kanë dhënë rezultate më të mira për nxënësit gjatë ushtrimeve dhe testeve, shumica e mësimdhënësve pajtohen me këtë fakt, por një pjesë e tyre këtë model e konsiderojnë të papërshtatshëm për lëndën e tyre.

Pyetjes “ Me disa fjalë përshkruani përshtatjen e lëndës tuaj me përdorimin e TIK gjatë procesit mësimor dhe modelet e reja të mësimdhënies që burojnë nga TIK” disa nga mësimdhënësit iu përgjigjën në këtë mënyrë:

- “Pasi teknologjia po gjen zbatim kudo, edhe neper shkolla mendoj se e ka efektin e saj pozitiv. Ne lenden e fizikes mendoj se eshte e pershtatshme per menyren e prezantimit te njesive mesimore dhe ushtrimeve ne forme kuizesh. Por nuk e perjashtoj mesimin e kombinuar kur une dhe nxenesit duhet ti zgjidhim detyrat ne formen klasike”.

- “Lenda e biologjise eshte lende ku duhet patjeter perdorimi i TIK-ut, per shkak se me ndimon t'ju tregoj nxenesve gjera (qeliza, mikroorganizma, struktura e ADN-se, mutacione, etj) te cilat nuk shihen me syrin e njeriut, me ndimon qe me ane te videove te tregoj shume procese jetesore, te cila po te mos ishte TIK- ut do te ishim shume te pa qarta per nxenesit. Une e perdor TIK-ut gati ne cdo ore mesimore sepse mendoj se mesimi eshte shume me efikas per nxensit”.

- “Në lenden e sociologjise zbatimi i TIK dhe modelet e reja te mesimdhënies pershtaten shume mire, demonstrimi i fakteve mund te jepet ne forme te prezentimeve, ushtrimet dhe perseritjet mund te behen ne forme te kuizeve por metoda e diskutimit te problemeve shoqerore eshte gjithashtu e domosdoshme”.

- “Mendoj se per shkencat natyrore, metoda tradicionale e mesimdhënies eshte me e pershtatshme dhe efektive”.

- “Zbatimi i TIK në lëndën e gjeografisë është shumë i përshtatshëm për informacionet e sakta që mund të gjenden për një kohë të shkurtër dhe kuizet në formë elektronike janë interesante për ushtrimet dhe natyrën e lëndës”.
- “Edhe pse TIK po gjen hapësirën e duhur në lëndet e shkencave natyrore, mendoj se mesimi i kombinuar i metodave tradicionale me ato elektronike është më i suksesshem”.
- “Mendoj se në të gjitha lëndet aplikimi i TIK është i domosdoshëm, përfshirë edhe lëndet shkencore, sepse është shekulli i teknologjisë dhe ajo gjen aplikim në çdo fushë”.
- “Modelet e reja të mësimdhënies po ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e orëve mësimore të gjuhës, pasi nxënësit i tërheq teknologjia dhe nuk e ndjejnë presionin e metodave tradicionale të mësimin”.
- “ Nuk po gjej përshtatje të mirë të teknologjisë me lëndën time pasi nxënësit e humbasin përqëndrimin sa herë që inkuadroj TIK në orën mësimore”.
- “Lënda e kimisë ka hapësirë për zbatim të TIK, por për ushtrimet laboratorike janë të domosdoshme kabinetet dhe kushtet për të zhvilluar ato”.

4.4.3. Analiza e pyetësorit III

Ky pyetësor u është drejtuar nxënësve në lidhje me lëndën e matematikës. Si e vlersojnë ata veten e tyre në këtë lëndë, cila është mënyra më e përshtatshme sipas tyre që kjo lëndë të duket më tërheqëse, si ndikon teknologjia në këtë lëndë, sa është i përshtatshëm TIK dhe modelet bashkëkohore të mësimdhënies për këtë lëndë e kështu me radhë.

Pyetësorit i’u përgjigjën 60 nxënës të shkollave të mësme.

Për një pjesë të nxënësve matematika është ndër lëndët e preferuara të tyre, por për pjesën dërmuese ajo është lënda më e vështirë. Prandaj është paraqitur nevoja e zbatimit të modeleve të reja të mësimdhënies në këtë lëndë.

7. Modelet e reja të mësimdhënies në lëndën e matematikës, duke zbatuar TIK:

59 responses




Figure 47. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit III

Në pyetjen e parashtruar në anketë “ Përshkruani me pak fjalë si do të zhvillohet një orë e matematikës, ideale dhe efektive për ju si nxënës!”

Disa nga përgjigjet e nxënësve ishin si më poshtë:

- “Një orë e kombinuar,me sqarim nga profesorja,me shënime,video materiale dhe kuize matematikore”.
- “Pikë së pari marrëdhënia mësimdhënës-nxënës duhet të jetë e shëndoshë, gjatë orës mësimore të përfshihen më tepër nxënësit pasi nuk mund te mësojmë vetem duke dëgjuar, te praktikohen me tepër problemet matematikore në klasë, dhe të zhvillohen kuize për kontrollim të njohurive cdo 3-4 orë dhe jo deri ne 10-14 orë sepse kjo shkakton ngarkesë dhe pengon marrjen e njohurive dhe informacioneve ne mënyrë të shëndoshë”.
- “Jo cdoherë por kur është e vështirë për tu kuptuar mësimdhenesi duhet ta bëjë me te kuptueshë mësimin me ndonjë kuiz apo ta shndëtrojë në lojë dhe mendoj se kjo do te ishte me e kuptueshme per ne si nxënës për shkak të përqëndrimit maksimal në to”.
- “Në klasë me spjegim nga mësuesja, me detyra te zgjidhura ne grup me shoket duke bashkepunuar dhe me kuize matematikore”.
- “Në prezencë fizike, me spjegim nga ana e mësimdhënësit dhe ushtrime në formë të kuizeve”.
- “Online me lojëra dhe kuize”
- “Një ore ideale ndoshta do te ishte kombinimi i mënyrës tradicionale me kuize te ndryshme,sepse jan kuizet ato te cilat na e bëjnë orën me interesante”.

Edhe në lëndën e matematikës, aplikacionet për kuize dhe lojëra që janë përdorur më së shumti janë Kahoot! dhe Quizizz.

8. Aplikacioni për kuize-lojëra që ne e përdorim në lëndën e matematikës është

60 responses





Figure 48. Përfaqësimi në përqindje i secilës nga përgjigjet tek pyetja e pyetësorit III

Në mendimet e tyre në lidhje me lëndën e matematikës, shumica e nxënësve e pohuan se matematika është lëndë e vlefshme dhe e nevojshme. Gjithashtu shprehën dëshirën për ta mësuar atë lëndë, mirëpo mungesa e njohurive bazike që ka ndikuar negativisht në motivimin e tyre ka bërë që zbatimi i modeleve të reja të duket interesante në këtë lëndë. Një pjesë e madhe e tyre u pajtuan se zbatimi i TIK në matematikë ka krijuar një atmosferë motivuese dhe bashkëpunuese në klasë dhe inkuadrimi i lojërave me karakter garues ka rritur angazhimin dhe përqëndrimin e tyre në këtë lëndë si pasojë e dëshirës për të fituar dhe rezultateve të mira që ata zakonisht i arrijnë.

Ju lutem, shënoni rënkën nga përgjigjet që i përshtatet më së miri mendimit tuaj!



4.4.4. Analiza e intervistës me mësuesin e matematikës

Në intervistën me mësuesin e matematikës, përgjigjet konkrete të të cilit janë paraqitur më lartë, u vërejt një mbështetje e madhe për inkuadrimin e modelit gamification në procesin mësimor në përgjithësi dhe në lëndën e matematikës në veçanti. Është njohur me këtë model nëpërmjet trajnimeve në formë elektronike dhe ka pasur dyshimet e veta nëse ky model do të ishte i përshtatshëm për lëndën e matematikës. Edhe pse mësuesi në fjalë po e shfrytëzon për 5 vite me radhë këtë model mësimor, disa nga kolegët e tij nuk e kanë të njohur aspak si model mësimor. Sido mëtej gjatë periudhës së pandemisë zbatimi i këtij modeli u vu në funksion të lëndëve mësimore nga disa mësues, dhe dha rezultate shumë të mira.

Thekson se karakteri garues i lojërave në formë kuizesh që i zhvillojnë gjatë ushtrimeve matematikore ka rritur angazhimin e nxënësve dhe rezultatet janë përmirësuar dukshëm.

Nëpërmjet aplikacioneve që e zbatojnë këtë model, ka arritur të zhvillojë ushtrimet dhe testet kontrolluese dhe ka pranuar se shpërblimet gjatë ushtrimeve kanë rritur motivimin e nxënësve dhe rezultatet në testet në formë kuizesh vetëbesimin e tyre.

Përshtatja e zhvillimit të orës mësimore me kërkesat e nxënësve është parësore. Mënyra e vlerësimit të nxënësve bazohet në një mesatare të të gjithë aktivitetit të tyre mësimor që nga detyrat e shtëpisë deri te të arriturat e tyre në testet kontrolluese.




Figure 49. Ndërlidhja: mësimdhënës - modeli *gamification* - nxënës

4.4.5. Analiza e rezultateve të nxënësve në test

Në pjesën e parë të testit nxënësit e njëjtë u testuan në formë tradicionale, me mënyrën klasike të testimit me laps dhe letër dhe në formë elektronike në të dy aplikacionet Kahoot! dhe Quizizz ku testet ishin paraprakisht të pregaditura nga mësimdhënësi.

Në testin e zhvilluar në formë tradicionale janë arritur këto rezultate:

18 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 1 (Pamjaftueshëm).

9 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar notën 2 (Mjaftueshëm).

18 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 3 (Mirë).

32 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 4 (Shumë mirë).

23 % e nxënësve janë vlerësuar me notën 5 (Shkëlqyeshëm).

Rezultatet e testit në formë tradicionale




Figure 50. Diagram sektorial i përfaqësimit në përqindje të rezultateve të testit në formë tradicionale.

Në testin e zhvilluar me aplikacionin Kahoot! janë arritur këto rezultate:

59 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 1 (Pamjaftueshëm).

23 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 2 (Mjaftueshëm).

9 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 3 (Mirë).

9 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 4 (Shumë mirë).

Asnjë nxënës nuk është vlerësuar me notën 5 (Shkëlqyeshëm).

Rezultatet e testit me Kahoot!




Figure 51. Diagram sektorial i përfaqësimit në përqindje të rezultateve të testit në Kahoot!

Në testin e zhvilluar me aplikacionin Quizizz janë arritur këto rezultate:

18 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 1 (Pamjaftueshëm).

9 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 2 (Mjaftueshëm.)

9 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 3 (Mirë).

19 % e nxënësve të klasës janë vlerësuar me notën 4 (Shumë mirë).

45 % e nxënësve janë vlerësuar me notën 5 (Shkëlqyeshëm).

Rezultatet e testit në Quizizz




Figure 52. Diagram sektorial i përfaqësimit në përqindje të rezultateve të testit në Quizizz.

Table 6. Rezultatet e testimit me shkrim të grupit të II të nxënësve të vitit I

Nr.	Nxënësi	Rezultatet e testit kontrollues në formë tradicionale	Rezultatet e testit në Kahoot!	Rezultatet e testit në Quizizz
